

AKTGJYKIM

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Qarkut në Prishtinë, në trupin gjykues përbërë nga:

Cornelie Peeck, kryetare e trupit gjykues
Shemsi Hajdini, anëtar i trupit gjykues
Vladimir Mikula, anëtar i trupit gjykues;

procesmbajtës Joseph Hollerhead;

Në lëndën penale kundër:

IT, AP, IH, HF, ZK, BF dhe BB;

Akuzuar për veprat penale:

1. Shpërdorimi i pozitës zyrtare ose i autorizimit, në kundërshtim me nenin 339 paragrafi 1 dhe 3 lidhur me nenin 23 KPK (të gjithë të pandehurit);
2. Shpërdorimi i pozitës zyrtare në tentativë, në kundërshtim me nenin 339 paragrafi 1 dhe 3, lidhur me nenin 20 dhe 23 KPK (AP dhe IT);
3. Keqtrajtimi gjatë ushtrimit të detyrave, në kundërshtim me nenin 164 paragrafi 1, lidhur me nenin 23 (IT dhe BF);
4. Marrja e ryshfetit, në kundërshtim me nenin 343 paragrafi 2 KPK (IH, IT dhe HF)
5. Shmangja nga tatimi, në kundërshtim me nenin 249 paragrafi 2 KPK (IT),
6. Pengimi i të provuarit, në kundërshtim me nenin 309 paragrafi 1 dhe 2 KPK (IT);

Pas mbajtjes së seancave publike më datat 10 janar, 8, 13, 14, 15, 21, 22 dhe 28 shkurt, 1, 7, 8, 13, 14, 15, 22, 27, 28 dhe 29 mars, 11 dhe prill, 15, 16, 17, 22, 23, 24, 29, 30 dhe 31 maj dhe 6, 12 dhe 13 qershor 2013, në praninë e prokurores së PSRK-së Maria Bamieh dhe të akuzuarve të përmendur më lart. Avokatët mbrojtës Korab Rexhepi dhe Rezerta Metaj për IT, Naser Peci për AP, Fatmir Aliu për IH, Ramë Gashi për HF, Xhevdet Shala për ZK, Osman Mehmeti për BF dhe Besnik Berisha për BB dhe palët e dëmtuara JX (përfaqësues BD), SX (përfaqësues MA), YX (përfaqësues AR), PX (përfaqësues FL), FC dhe BM, Ministria e Shëndetësisë dhe përfaqësuesit e tyre AK për JX, NK për Ministrinë e Shëndetësisë, BMA për YX dhe SM për PX ishin të pranishëm ose janë ftuar të jenë të pranishëm;

Pas diskutimit të trupit gjykues më datë 14 qershor 2013, sipas Nenit 363, 364 dhe 365, më datë 18 qershor 2013 u shpall publikisht aktgjykimi vijues.

DISPOZITIVI

1. IT, emri i babait XX, lindur më datë XX në XX, jeton në XX, XX, kosovar shqiptar;
2. AP emri i babait XX, lindur më datë XX në XX, jeton në XX, XX, kosovare shqiptare;
3. IH, emri i babait XX, lindur më datë XX në XX, jeton në XX, XX, kosovar shqiptar;
4. HF, emri i babait XX, lindur më datë XX në XX, jeton në XX, XX, kosovar shqiptar;
5. ZK, emri i babait XX, lindur më datë XX në XX, jeton në XX, XX, kosovar shqiptar;
6. BF, emri i babait XX, lindur më datë XX në XX, jeton në XX, kosovar shqiptar;
7. BB, emri i babait XX, lindur më datë XX në XX, jeton në XX, XX, kosovar shqiptar;

Akuza 1.1

AP dhe IT **LIROHEN** nga akti përshkruar në aktakuzë, akuza 1.1, se ata duke vepruar së bashku, përkatësisht si zyrtare për furnizim dhe Sekretar i Përhershëm në Ministrinë e Shëndetësisë mes datës 26 shtator 2007 dhe 1 tetor 2007, kanë lejuar skadimin e një kontrate detyrimore të ligjshme me JX, së datës 26 shtator 2006, duke mos iu përmbajtur kushteve të kontratës. Kjo rezultoi në humbje mbi 1.5 milionë euro për Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës përveç shpenzimeve shtesë për procesin e ri dhe të panevojshëm të tenderit.

Akuza 1.2

IT **LIROHET** nga akti i përshkruar nën akuzën 1.2 të aktakuzës se ai si Sekretar i përhershëm në dhjetor 2007 i ka thënë komisionit për vlerësim të tenderëve emergjentë 71300007737126 dhe 7130007789126 se cili operator duhej të zgjidhej. Ai e ka bërë këtë sepse nuk donte të respektonte kontratat ekzistuese të Ministrisë së Shëndetësisë meqenëse ai ka dashur të lëshonte kontrata të reja në interesin e tij dhe për përfitimin material të atyre me të cilët kishte lidhje, financiare apo të tjera.

Akuza 1.3

IT dhe AP **SHPALLEN FAJTORË** për aktin përshkruar në mënyrë të qartë nën akuzën 1.3 të aktakuzës se ata më datë 7 dhjetor 2007 duke vepruar së bashku respektivisht si Sekretar i Përhershëm dhe zyrtare/anëtare e komisionit për vlerësim në Ministrinë e Shëndetësisë kanë kërkuar nga RH, edhe ata të dy dhe përmes APO, të nënshkruajë se ka marrë pjesë në vlerësimin e tenderit 71300007737126 ku ajo nuk kishte marrë pjesë. RH e nënshkroi formularin e vlerësimit. Duke vepruar në këtë mënyrë ata kanë kryer veprën penale nxitje për të

falsifikuar dokumente zyrtare në bashkëveprim, siç parashihet nga Neni 348 KPK lidhur me nenin 23 dhe 24 KPK.

IT dhe AP **LIROHEN** nga akti përshkruar nën akuzën 1.3 të aktakuzës se ata në datë 27 dhjetor 2007 duke vepruar së bashku respektivisht si Sekretar i Përhershëm dhe zyrtare/anëtare e komisionit për vlerësim në Ministrinë e Shëndetësisë kanë kërkuar nga RH, edhe ata të dy dhe përmes APO, të nënshkruajë se ka marrë pjesë në vlerësimin e tenderit 7130007789126 ku ajo nuk kishte marrë pjesë. RH e nënshkroi formularin e vlerësimit.

Akuza 1.4

IT, AP dhe IH **LIROHEN** nga akti përshkruar nën akuzën 1.4 të aktakuzës se ata gjatë datave të ndryshme në dhjetor 2007 respektivisht si Sekretari i Përhershëm, zyrtare për furnizim dhe zyrtar për prokurim në Ministrinë e Shëndetësisë kanë patur kontakte jo të përshtatshme me operatorë ekonomikë LX, EX dhe KX përmes telefonatash dhe takimesh.

Akuza 1.5

AP **LIROHET** nga akti përshkruar nën akuzën 1.5 të aktakuzës se ajo më datë 27 dhjetor 2007 si zyrtare në Ministrinë e Shëndetësisë nuk u tërhoq nga komisioni për vlerësim për shkak të një konflikti interesash që kishte duke qenë se kishte qenë shoqe e BS dhe se punonte për vëllain e tij AS.

Count 1.6

IT dhe AP **LIROHEN** akti përshkruar nën akuzën 1.6 të aktakuzës se ata duke vepruar së bashku, përkatësisht si Sekretar i Përhershëm dhe zyrtare për furnizim në Ministrinë e Shëndetësisë në dhe rreth nëntorit dhe dhjetorit 2007 kanë pasur takime me furnizues në data të ndryshme mes 15 dhe 18 nëntorit ku është kërkuar nga furnizuesit të cilët nuk ishin në gjendje të furnizonin që të siguronin garanci bankare deri më datë 21 dhjetor 2007. Garancitë bankare janë pranuar nga AP e cila i tha gjithashtu komisionit për pranim që të nënshkruante një deklaratë të rreme të pranimit të ilaçeve nga furnizues të cilët nuk ishin në gjendje të furnizonin Ministrinë e Shëndetësisë para datës 21 dhjetor 2007. IT dhe AP kanë mundësuar furnizuesit të marrin përfitim material, përkatësisht parapagim përmes mashtrimit. AP ka mashtruar gjithashtu Ministrinë e Financave duke i thënë komisionit për pranim që të nënshkruajë certifikata pranimi të rreme duke pretenduar se malli ishte pranuar kur në fakt nuk ishte pranuar.

AP **SHPALLET FAJTORE** lidhur me aktin përshkruar nën akuzën 1.6 të aktakuzës se ajo gjatë datave të ndryshme mes datës 21 dhjetor 2007 dhe 31 dhjetor 2007 si zyrtare për furnizim në Ministrinë e Shëndetësisë i ka thënë një anëtar të komisionit për pranim që të nënshkruajë një deklaratë pranimi ilaçesh nga furnizues të cilët nuk ishin në gjendje të furnizonin Ministrinë e Shëndetësisë para datës 21 dhjetor 2007, kur në fakt mallrat nuk ishin pranuar fizikisht. Anëtar i nënshkroi deklaratën megjithëse mallrat nuk ishin pranuar. Duke vepruar në këtë mënyrë ajo ka kryer veprën penale të nxitjes në falsifikimin e dokumenteve zyrtare siç parashihet nga neni 348 KPK lidhur me nenin 24, KPK.

Akuza 1.7

IT, AP, ZK, HF, BF dhe BB **LIROHEN** nga akti përshkruar nën akuzën 1.7 të aktakuzës se ata kanë vepruar së bashku gjatë datave të ndryshme në periudhën kohore nga 1 qershori 2010 deri 30 nëntor 2010 respektivisht në cilësinë e Sekretarit Permanent, Zyrtares për Furnizim, Drejtor i Departamentit të Prokurimit, Drejtor i Cilësisë, Drejtor i Departamentit Farmaceutik dhe Ministër i Shëndetësisë, në Ministrinë e Shëndetësisë kanë bërë fushatë për të dëmtuar kompanitë JX dhe YX. Fushata kishte për qëllim që të sigurohej që JX dhe YX të mos fitonin asnjë kontratë me MeSH, duke dërguar inspektorë tek kompania “JX” dhe duke kërkuar nga ata që t’i ndëshkonte, të përpilonin një numër shumë të madh kallëzimesh penale dhe ankesa civile kundër JX dhe YX dhe suke përdorur ndikimin e tyre që të siguronin që JX dhe YX të mos merrnin licensa importi dhe eksporti.

Akuza 1.8

IT dhe BB **LIROHEN** nga akti përshkruar nën akuzën 1.8 të aktakuzës se në një datë në qershor 2010 IT në cilësinë e Këshilltarit personal të BB, i cili ishte Ministri i Shëndetësisë, ka ndikuar këtë të fundit për të siguruar që kontratat një plus një që ishin fituar nga JX dhe YX të mos vazhdoreshin. Gjatë një takimi me operatorët ekonomikë IT i tha FC se ‘nuk dërgohen shokët në gjykatë’. Drejtori i Prokurimit EM ishte udhëzuar që të mos vazhdonte kontratën megjithëse kjo e fundit ishte përgatitur. HK dhe EM kishin përgatitur kontratat por BB nuk nënshkroi kontratat për YX apo për JX.

Akuza 1.9

IT, HF, BF dhe ZK **LIROHEN** nga akti përshkruar nën akuzën 1.9 të aktakuzës se ata duke vepruar së bashku respektivisht në cilësinë e Sekretarit Permanent, Drejtor i Cilësisë, Drejtor i Departamentit Farmaceutik dhe Drejtor i Departamentit të Prokurimit në Ministrinë e Shëndetësisë mes datës 1 mars 2011 dhe 30 prill 2011 i kanë dhënë një kontratë kompanisë “LX” lidhur me tenderin numër 206/11/029/111, loti 20, ku ata kanë dështuar të zbatojnë procedurat e tenderit sepse ka patur një raport përfundimtar dhe të nënshkruar që kontrata i ishte dhënë kompanisë JX. ZK, në cilësinë e Drejtorit të Prokurimit, nuk e nënshkroi atë dhe pak kohë pas kësaj kërkoi nga i njëjti panel që të rivlerësonte tenderin. Të gjitha kompanitë që kishin parashtruar oferta që ishin më të lira se ajo e kompanisë LX ishin eliminuar.

Akuza 1.10

IT, BF dhe ZK **LIROHEN** nga akti përshkruar nën akuzën 1.10 të aktakuzës se ata në cilësinë e Sekretarit Permanent, respektivisht Drejtor i Departamentit Farmaceutik dhe Drejtor i Departamentit të Prokurimit mes datës 1 janar 2009 dhe 31 dhjetor 2011 kanë publikuar dhe pastaj pa arsye kanë anuluar tenderët për ilaçet esenciale Beta Interferon 1b dhe Fludarabine sepse furnizuesi i vetëm i këtyre ilaçeve MA nuk pëlqejë nga Ministria sepse më parë kishte shkuar në shtyp. Ministria kishte vazhduar të prishte dhe anulonte tenderët për këto ilaçe furnizuar nga SX dhe nuk kishte përdorur përjashtimet në Ligjet e Prokurimit. Duke vepruar në këtë mënyrë, IT, BF dhe ZK lanë pacientët në Kosovë të vuanin nga Leukemia dhe Skleroza e Shumëfishtë pa ilaçe de njëkohësisht ata shpenzonin buxhetin për ilaçe që ishin për sëmundje më pak të rrezikshme për jetën.

Akuza 1.11

HF, ZK dhe IT **LIROHEN** nga akti përshkruar nën akuzën 1.11 të aktakuzës se ata duke vepruar së bashku në cilësinë e Sekretarit Permanent, respektivisht Drejtor i Departamentit Farmaceutik dhe Drejtor i Departamentit të Prokurimit në Ministrinë e Shëndetësisë në apo rreth muajve nëntor dhe dhjetor 2010 kanë thirrur FL në Ministrinë e Shëndetësisë ku HF i ka kërkuar atij të paguajë 10% për vazhdimin e kontratës së tij 1+1, kontratë nënshkruar më datë 9 dhjetor 2009. Z. FL nuk i pagoi paratë dhe kontrata e tij nuk u vazhdua. Ministria publikoi përsëri kontratën për ilaçet ku përfshiheshin infuzionet nga kontrata e Z. FL– megjithëse infuzionet nuk ishin publikuar në mënyrë specifike në tender. Ndërprerja e kësaj kontrate dhe publikimi i tenderit për furnizimet në kontratë ishte autorizuar nga Sekretari i Përhershëm IT. Drejtori i Prokurimit, ZK, nënshkroi të gjitha dokumentet relevante.

Akuza 1.12

IT, HF dhe ZK **LIROHEN** nga akti përshkruar nën akuzën 1.12 të aktakuzës se ata duke vepruar së bashku në cilësinë e Sekretarit Permanent, respektivisht Drejtor i Departamentit Farmaceutik dhe Drejtor i Departamentit të Prokurimit në vitin 2011 i kanë dhënë një kontratë kompanisë AX. Ata kanë dështuar të kontrollojnë dokumentet për të siguruar se ata ishin tre ofertuesit e përgjegjshëm dhe për të kontrolluar se nuk ka patur konflikte interesi. Kjo ka rezultuar në atë që operatorët ekonomikë, BA i kompanisë AX, KX dhe KWX, të jenë në gjendje të rregullojnë çmimet.

Akuza 1.13

ZK **LIROHET** nga akti përshkruar nën akuzën 1.13 të aktakuzës se ai në periudhën kohore nga data 31 korrik 2010 deri më datë 12 janar 2012 në cilësinë e Drejtorit të Departamentit të Prokurimit në Ministrinë e Shëndetësisë ka dështuar të mbajë dokumentet e tenderit.

Akuza 2

IT, IH dhe AP **LIROHEN** nga akti përshkruar nën akuzën 2 të aktakuzës se ata duke vepruar në cilësinë e Sekretarit të Përhershëm respektivisht zyrtar prokurimi dhe zyrtare furnizimi në Ministrinë e Shëndetësisë më datë 30 nëntor 2007 në një takim me pronarin e kompanisë JX, BD, i kanë ofruar që t'i japin kompanisë së tij një tender emergjent në shkëmbim të tërheqjes së padisë që JX kishte ngritur kundër Ministrisë së Shëndetësisë.

Count 3

IT **LIROHET** nga akti përshkruar në akuzën 3.1 të aktakuzës se ai gjatë periudhës kohore mes datës 1 qershor 2010 dhe 31 korrik 2010 ndërkohë që punonte si Këshilltar Personal i Ministrit të Shëndetësisë, i ka thënë FC se nuk çohen shokët nëpër Gjykata.

IT dhe BF **LIROHEN** nga akti përshkruar nën akuzën 3.2 të aktakuzës se ata duke vepruar si Sekretari i Përhershëm dhe respektivisht Drejtori i Departamentit Farmaceutik në periudhën kohore mes datës 1 dhjetor 2011 dhe 11 janar 2012 kërcënuan BM;

Akuza 6

Akuza nën pikën 6 kundër të pandehurit IT, se ai së bashku me dikë tjetër kanë shpërdoruar pozitën zyrtare **REFUZOHET**;

Count 8

IT **LIROHET** nga akti përshkruar nën pikën 8 të aktakuzës se ai së bashku me të tjerët duke veprua në cilësinë e Sekretarit të Përhershëm në Ministrinë e Shëndetësisë në data të ndryshme në vitin 2007, 2010 dhe 2011 ka kërkuar ryshfet;

IH **LIROHET** nga akti përshkruar nën pikën 8 të aktakuzës se ai si zyrtar prokurimi në Ministrinë e Shëndetësisë në një datë në vitin 2007 i ka thënë FC se ai duhej të paguante pjesën 10% nëse donte të fitonte një kontratë me Ministrinë;

HF **SHPALLET FAJTOR** për aktet e përshkruara nën pikën 8.2 të aktakuzës se ai si zyrtar i Ministrisë së Shëndetësisë në një datë në vitin 2011 i ka thënë MA se ai duhej të jepte pjesën prej 10% nëse donte të fitonte një kontratë me Ministrinë. Duke vepruar kështu ai ka kryer veprën penale të marrjes së ryshfetit siç është paraparë nga neni 343 paragrafi 2 KPK;

HF **SHPALLET FAJTOR** për aktin e përshkruar nën pikën 8.3 të aktakuzës se ai si zyrtar i Ministrisë së Shëndetësisë në apo rreth muajit nëntor 2010, i ka kërkuar FL një pjesë 10% nëse ai donte që kontrata e tij një plus një të vazhdohej. Duke vepruar në këtë mënyrë ai ka kryer veprën penale të marrjes së ryshfetit siç është paraparë nga neni 343 paragrafi 2 KPK.

Count 9

IT is **SHPALLET FAJTOR** për aktin përshkruar në pikën 9 të aktakuzës se ai nuk ka deklaruar në kohë të ardhurat e tij jashtë vendit gjatë viteve 2006, 2007 dhe 2008. Duke vepruar në këtë mënyrë ai ka shmangur pagesën e taksës mbi të ardhurat siç parashihet nga neni 313 KPK;

Count 10

IT **LIROHET** nga aktet përshkruar nën pikën 10 të aktakuzës se ai gjatë datave të ndryshme mes datës 12 janar 2012 dhe 25 qershor 2012 ka kontaktuar Kryeprokurorin e EULEX-it dhe Kryetarin e Asamblesë së Gjykatësve të EULEX-it për të hequr prokurorin nga lënda dhe për të hedhur poshtë lëndën kundër tij dhe/ose për të vendosur vendimin mbi konfirmimin në favorin e tij. Ai donte gjithashtu që të kontaktoheshin ekspertët në lëndë me qëllim që ata të drejtonin ekspertizën në favorin e tij. Ai ishte në kontakt me zyrtarë në Ministrinë e Shëndetësisë për të vonuar kërkesat e prokurorit lidhur me dokumente dhe për të bërë kopje të dokumenteve të cilat kërkoreshin apo ishin shkruar nga Prokurori. Së bashku me dikë tjetër ai po planifikonte që të paguanin para për një ndihmë të tillë. Së bashku me dikë tjetër ai po planifikonte dhe ka pretenduar se ka neutralizuar dëshmitarë të ndryshëm. Së bashku me një person tjetër ai ka kontaktuar personelin e EULEX-it për t'u dhënë atyre dokumente konfidenciale.

Count 11

BB **LIROHET** nga akti përshkruar nën pikën 11 të aktakuzës se ai duke vepruar në cilësinë e Ministrit të Shëndetësisë më apo rreth muajve shtator/tetor 2010 ka zbatuar Aktgjykimin e

Gjykatës Supreme të datës 8 shtator 2010 në të cilin ishte miratuar ankesa e ushtruar nga IT. Duke vepruar në këtë mënyrë ai ka rikthyer IT në postin e Sekretarit të Përhershëm në shkelje të Ligjit mbi Shërbimin Civil, sepse IT ishte arrestuar më datë 13 korrik 2010 dhe se ishte bërë një kërkesë për paraburgimin e tij.

Akuza 12

IT dhe HF **LIROHEN** nga akti përshkruar nën pikën 12 të aktakuzës se ata duke vepruar më apo rreth datës 24 dhjetor 2010 respektivisht si Sekretar i Përhershëm dhe anëtar i komisionit për vlerësim për tenderin 71300/10/647/111 kanë këmbëngulur që EM të nënshkruante formularin e vlerësimit për këtë tender duke ia dhënë tenderin FXit, megjithëse kjo ishte në shkelje të patentës ndërkombëtare të NX.

DËNIMET

AP

Sipas Nenit 34, 41, 42, 43, 44 dhe 348, paragrafi 1 lexuar me nenin 23 dhe 24, KPK e pandehura dënohet me kusht me 6 muaj burgim (akuza 1.3);

Sipas Nenit 34, 41, 42, 43 44 348, paragrafi lexuar me nenin 23 dhe 24, KPK e pandehura dënohet me kusht me 6 muaj burgim (akuza 1.6);

Sipas nenit 71 lexuar me nenin 52 KPRK Gjykata cakton dënimin unik prej 8 muajsh i cili nuk do të ekzekutohet nëse e pandehura nuk kryen vepër tjetër penale për një periudhë kohore prej dy vjetësh nga momenti kur ky aktgjykim të bëhet i plotfuqishëm;

Sipas nenit 54 lexuar me nenin 56 KPK e pandehura e ka të ndaluar të ushtrojë funksione publike në administrate apo shërbimin publik për periudhën kohore prej dy vjetësh;

IT

Sipas Nenit 34, 36, 38 dhe 348, paragrafi 1 lexuar me nenin 23 dhe 24 KPK i pandehuri dënohet me burgim prej 10 muajsh (akuza 1.3);

Sipas Nenit 249, paragrafi 1 KPK i pandehuri dënohet me 9 muaj burgim (akuza 9);

Sipas Nenit 39 dhe 249, paragrafi 1 KPK i pandehuri dënohet me gjobë prej 1000 euro (akuza 9);

Sipas Nenit 80 KPRK Gjykata cakton dënimin unik prej 18 muajsh;

Gjoha duhet të paguhet brenda 2 muajve nga momenti kur ky aktgjykim shpallet i plotfuqishëm;

Koha kaluar në paraburgim dhe në arrest shtëpiak llogaritet në dënimin me burgim;

Sipas Nenit 54 KPRK të pandehurit i ndalohet ushtrimi i funksioneve në administratë apo shërbimin civil për 3 vjet;

HF

Sipas Nenit 34, 36, 38 dhe 343, paragrafi 2 KPK i pandehuri dënohet me gjashtë muaj burgim për secilin akt për shkruar në akuzën 8.2 dhe 8.3 (akuza 8)

Sipas nenit 80 lexuar me nenin 52, KPRK, Gjykata cakton dënimin unik prej the 8 muajsh kundër të pandehurit;

Sipas nenit 54 KPRK të pandehurit i ndalohet ushtrimi i funksioneve në administratë apo shërbimin civil për 3 vjet;

Koha kaluar në paraburgim llogaritet në dënimin me burgim.

SHPENZIMET

Të pandehurit IT, AP dhe HF detyrohen të paguajnë shpenzimet e procedurës penale në shumën prej 1000 EURO, sipas nenit 453 paragrafi, KPP.

Shpenzimet përse i përket të pandehurve IH, BB, ZK dhe BF do të paguhet nga buxheti i Kosovës.

KËRKESAT PËR KOMPENSIM

Palët e dëmtuara referohen që të materializojnë kërkesat për dëmshpërblim përmes një padie civile.

ARRESTI SHTËPIAK

Arresti shtëpiak i të pandehurit IT ndërpritet që nga dita e sotme për të cilën do të nxirret një vendim i veçantë.

LLOGARITË BANKARE

Llogaritë e bllokuara bankare të AP dhe IT do të zhblokohen përmes një vendimi të veçantë.

ARSYETIMI

Cështjet paraprake

Ligji i zbatueshëm

Sipas nenit 3 paragrafi 1 dhe 2 , Kodi Penal i Republikës së Kosovës ligji i zbatueshëm është ligji i cili ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale (*Gjykata shkruan: akti*). Në rast se ka patur ndryshim të ligjit pas kësaj kohe apo para vendimit final duhet të zbatohet ligji më i favorshëm për të pandehurin.

Përse i përket ligjit më të favorshëm, duhet të bëhet dallim mes përshkrimit të veprës penale si dhe dënimit të paraparë.

Përsa i përket veprës penale të Shpërdorimit të pozitës zyrtare Gjykata konsideron se KPRK është më pak i favorshëm, sepse elementi i **paligjshmërisë** është hequr nga kodi. Kjo do të thotë se prokuroria nuk ka për detyrë të vërtetojë paligjshmërinë e përfitimit të synuar. Për këtë arsye ligji i zbatueshëm është KPK lidhur me aktin.

Kodi i procedurës që zbatohet është KPP. Neni 541 paragrafi 2 KPP parasheh se procedura penale në të cilën është konfirmuar aktakuza për mes një vendimi final para hyrjes në fuqi të KPP do të përfundohej në bazë të dispozitave të KPP. Gjykata kupton fjalën “përfundohej” se shqyrtimi kryesor do të procedohet sipas KPP. Në këtë lëndë aktakuza ishte finale para hyrjes në fuqi të KPP dhe për këtë arsye shqyrtimi kryesor është zhvilluar sipas KPP.

Aktakuza

Gjykata ka vënë re se aktakuza është konfirmuar megjithëse kanë munguar elementë thelbësorë. Akuzat 1.2, 1.3, 1.4, 1.5, 1.7, 1.12, 1.13 dhe 6 nuk përmbajnë datën në të cilat janë kryer aktet. Në rastet kur datat mungojnë, Gjykata ka konkluduar në datat relevante nga arsyetimi i aktakuzës.

Vlerësimi i Gjykatës është kufizuar në aktet të cilat janë objekt i një akuze e cila është pjesë e aktakuzës, ashtu siç është paraparë nga neni 360 paragrafi 1 KPP. Kjo do të thotë se ky aktgjykim mund të lidhet vetëm me aktet e përshkruara në akuzat e aktakuzës. Aktet e përshkruara në arsyetim ose “pretendimet faktike” të aktakuzës nuk mund të vlerësoheshin nga Gjykata si akuza në kuptim të Nenit 306 KPP dhe nuk janë pjesë e këtij aktgjykimi.

Pranueshmëria e provave

Gjykatësi për konfirmim ka deklaruar të papranueshme të gjitha provat, domethënë rezultatet e matjeve telefonike dhe mesazhet SMS, të siguruarat përmes urdhrit 302-2/08 datë 29 prill 2008 nga Prokurori Publik. Gjithashtu edhe deklaratat dhënë nga EM para prokurorit më datë 16 qershor 2011 dhe 29 dhjetor 2011 janë shpallur të papranueshme.

Kolegji prej tre gjykatësve deklaroi të papranueshme deklaratat dhënë nga HE para prokurorisë më datë 6 maj 2011 dhe 4 janar 2012.

Trupi Gjykues deklaroi të papranueshme deklaratat dhëna nga dëshmitarët APO, FA dhe BS kur këta ishin marrë në pyetje në cilësinë e të dyshuarve.

Trupi gjykues refuzoi kërkesën parashtruar nga prokurori për të mbledhur si prova të reja mesazhet SMS dhe rezultatet e matjeve telefonike të cilat ishin deklaruar të papranueshme nga gjykatësi për konfirmim. Gjykata nuk mund të lejojë që të merren prova ato të cilat më parë janë shpallur të papranueshme.

Gjatë fjalëve përfundimtare nuk u bënë dhe nuk u përsëritën parashtrësia të tjera.

Provat të cilat nuk u pranuan

Gjykata refuzoi kërkesën e AK për të marrë prova gjatë marrjes në pyetje të të pandehurit. Ai donte që të administrohej si provë incizimi nga një program televiziv. Meqënëse prova kishte qenë në posedimin e tij gjatë fazës së administrimit të provave Gjykata vendosi që kjo nuk ishte provë e re dhe për këtë arsye e refuzoi këtë provë.

Provat e Paraqitura

Gjatë shqyrtimit kryesor u administruan provat listuar në Shtojcën A. Kjo provë u konsiderua e lexuar me pëlqimin e palëve.

Gjatë shqyrtimit kryesor u dëgjuan dëshmitarët dhe ekspertët listuar në shtojcën B.

Deklarata e IQ u lexua me pëlqimin e palëve. Deklarata e NZ u lexua sepse dëshmitari nuk ishte në gjendje të vinte në gjykatë dhe një letër kërkesë rogatore do të shkaktonte vonesa në procedurë.

Më datë 12 prill 2013 në gjykatë u lëshua një pjesë nga programi Jeta ne Kosovë i datës 22 korrik 2010 lidhur me Paracetamolin e furnizuar nga JX. Në të njëjtën ditë u pa edhe një regjistrim i një mbledhje të qeverisë.

Gjetjet e Gjykatës

Lidhur me të gjitha pikat e aktakuzës Gjykata konsideron të vërtetuar faktin se i pandehuri IT ka punuar si Sekretar i Përhershëm nga data 9 gusht 2006¹ deri 10 mars 2007² dhe nga data 28 shtator 2010 deri më datë 11 janar 2012, kur ai u arrestua.³

AP ka punuar në Ministrinë e Shëndetësisë si zyrtarë furnizimi në departamentin Farmaceutik nga muaji prill 2005 deri maj 2011.⁴ IH ka pasur pozitë zyrtarë në Ministrinë e Shëndetësisë nga marsi 2004 deri 27 dhjetor 2007 si zyrtarë prokurimi dhe nga data 27 dhjetor 2007 deri në fund 2009 si (ushtrues detyre) drejtor i departamentit të prokurimit.⁵ BF ka punuar për Ministrinë e Shëndetësisë në pozitë zyrtarë nga muaji maj 2010 deri më datë 11 janar 2012 kur u arrestua, si drejtor i departamentit farmaceutik.⁶ ZK ka punuar për Ministrinë e Shëndetësisë në postin e drejtorit të departamentit të prokurimit nga data 28 dhjetor 2010 deri më datë 11 janar 2012 kur u arrestua.⁷ HF ka punuar për Ministrinë e Shëndetësisë si Drejtor i Cilësisë nga data 10 nëntor 2010 deri më datë 11 janar 2012 kur ai u arrestua.⁸ BB ka punuar në Ministrinë e Shëndetësisë si Ministër i Shëndetësisë nga data 6 prill 2010 deri më datë 18 tetor 2010.⁹

Akuza 1.1

Faktet e vërtetuara

AP ka punuar gjatë periudhës relevante si zyrtarë për furnizime në Ministrinë e Shëndetësisë. Ka qenë përgjegjësi e saj të kërkojë furnizime me medikamente nga departamenti i prokurimit bazuar në nevojat e institucioneve shëndetësore.

Një kontratë e vlefshme 3 milion euro është nënshkruar në mes të Ministrisë së Shëndetësisë dhe JX më 26 shtator 2006.¹⁰ Kontrata do të ishte përmbushur nëse do të ishte porositur 75-125% e vlerës së kontratës. Më 11 gusht/shtator 2007 JX ka kërkuar takim me IT si sekretar permanent sepse kontrata nuk ishte përmbushur dhe tenderi ishte ri-shpallur.¹¹ Më 26 shtator 2007 kontrata kishte skaduar. Në datën e caktuar kontrata ishte përmbushur 16%. JX kishte

¹ Provë shtesë, nëndosje 1 faqe 9 dhe 10;

² Provë shtesë, nëndosje 1 faqe 32/33 dhe 34/35;

³ Provë shtesë, nëndosje 1, faqe 47/48 dhe 49 dhe 50;

⁴ Deklaratë e AP, Procesverbal I shqyrtimit kryesor 16 maj 2013, faqe 22;

⁵ Deklaratë IH, Procesverbal I shqyrtimit kryesor 16 maj 2013, faqe 4;

⁶ Deklaratë BF, Procesverbal I shqyrtimit kryesor 23 maj 2013, faqe 2;

⁷ Deklaratë of ZK, Procesverbal I shqyrtimit kryesor 24 maj 2013, faqe 2;

⁸ Deklaratë HF, Procesverbal I shqyrtimit kryesor, 22 maj 2013, faqe 18;

⁹ Deklaratë BB, Procesverbal I Shqyrtimit kryesor 17 maj 2013, faqe 15;

¹⁰ Dosja 16A faqe 38-40 (anglisht), Dosja 16C, faqe 17-20 (shqip)

¹¹ Dosja 16A, faqe 43 (anglisht), Binder 16C, faqe 23

ngritur padi civile kundër Ministrisë së Shëndetësisë për mos-përbushje të kontratës më 1 tetor 2007. Më 14 mars 2008¹² dhe 3 qershor 2008¹³ JX kishte kërkuar nga Ministria e Shëndetësisë të arrijnë deri te një marrëveshje miqësore. Më 18 qershor 2008 Gjykata Ekonomike kishte vendosur në favor të JX dhe ka urdhëruar Ministrinë e Shëndetësisë të paguajë 1.5 milion euro kompensim.

Gjetjet

Trupi gjykues së pari vëren se asnjë nga veprimet e përshkruara në aktakuzë nën akuzën 1.1 nuk bie nën kornizën kohore 26 shtator 2007 dhe 1 tetor 2007.

Nga prokurori nuk është paraqitur asnjë provë se AP ka qenë në pozitë të përbushë kontratën e nënshkruar në mes të Ministrisë së Shëndetësisë dhe JX më 26 shtator 2006. Edhe pse ka pasur përgjegjësinë për të përgatitur kërkesat për furnizime, Prokuroria nuk ka dëshmuar se kontrata nuk është përbushur sepse AP ka dështuar të bëjë këtë. Prandaj, e pandehura duhet të lirohet nga veprimi i përshkruar në akuzën 1.1 në pajtim me nenin 364 nën 1.1 të KPP.

Edhe pse IT nuk është përgjigjur në kërkesat e bëra nga JX në gusht dhe shtator 2007 për të arritur deri te një zgjidhje për kontratën e pa përbushur, nuk mund të konkludohet se kjo ka çuar deri te mos-përbushja e kontratës. Nuk mund të dyshohet se IT gjatë periudhës gjashtë javore (nga momenti i fillimit të punës deri më 26 shtator 2007) do të ishte në gjendje të gjejë zgjidhje për kontratën e pa përbushur. Trupi gjykues konkludon që akuza se kontrata ka skaduar pa u përbushur si rezultat i ndonjë veprimi të IT nuk mund të dëshmohet. Prandaj, i pandehuri duhet të lirohet nga veprimi i përshkruar në akuzën 1.1, në pajtim me nenin 364 nën 1.1 të KPP.

Akuza 1.2

Nga arsyetimi i aktakuzës Trupi gjykues konkludon se veprimi është kryer në mes të datës 30 nëntor 2007 dhe 27 dhjetor 2007.

Faktet e vërtetuara

Më 6 dhjetor 2007 dhe më 27 dhjetor 2007, APO, AP dhe RH janë caktuar si anëtarë të komisionit për vlerësim të tenderit 71300 07 737 126¹⁴ respektivisht 71300 07 789 126¹⁵. Bazuar në vlerësimin, tenderi i parë i ishte dhënë KX-it dhe LX-it si ofertuesit më të lirë të përgjegjshëm dhe tenderi i dytë i ishte dhënë EX si ofertuesi më i lirë i përgjegjshëm.

Gjetjet

APO ka dëshmuar se IT i ka thënë atij dhe AP se cilat kompani duhet të shpallen fitues, edhe pse ka pasur oferta më të lira. Bazuar në kontratat që janë nënshkruar këto kompani janë LX, KX dhe EX.¹⁶

Deklarata e dhënë nga APO nuk mbështetet nga deklaratat e AP. Nga formularët e vlerësimit nuk mund të përfundohet se tenderët i janë dhënë kompanive të cilat nuk kanë qenë ofertuesit më të lirë të përgjegjshëm. Nuk ka prova që mbështesin pohimin e APO që procesi i tenderimit ka qenë i ujdisur me qëllim që tenderët t'i jepen kompanive të afërta me IT.

¹² Dosja 37, faqe 57-62 (ANG/SHQIP)

¹³ Dosja 38, faqe 260/260a (SHQIP/ANG)

¹⁴ Dosja 16C faqe 133 (SHQIP), Dosja 16A faqe 153-154 (ANG)

¹⁵ Dosja 16B faqe 176 (ANG) Dosja 16B faqe 180 (ALB)

¹⁶ Deklaratë APO procesverbal nga shqyrtimi kryesor 14 mars 2013 faqe 9;

I pandehuri duhet të lirohet nga veprimi i përshkruar në akuzën 1.2, në pajtim me nenin 364 nën 1.1 të KPP.

Akuza 1.3

Nga arsyetimi i aktakuzës Trupi gjykues vjen deri te përfundimi se veprimi është kryer gjatë periudhës kohore në mes të datës 6 dhjetor 2007 deri më 27 dhjetor 2007.

Faktet e vërtetuara

Më 6 dhjetor 2007 dhe më 27 dhjetor 2007 AP, APO dhe RH ishin caktuar si anëtarë të komisionit për vlerësim të tenderëve 7130007737126¹⁷ dhe 7130007789126¹⁸.

AP dhe APO kanë vlerësuar ofertat për këta tenderë pa praninë e RH në datat e përmendura.¹⁹

²⁰ Më 7 dhjetor 2007 APO ka kërkuar nga RH të shkojë te zyra e tij të nënshkruajë formularin e vlerësimit për tenderin 7130007737126. Ajo kishte shkuar te zyra e tij ku ishin të pranishëm IT, në atë kohë sekretar permanent, AP, si anëtare e komisionit dhe APO. IT dhe AP i kishin thënë RH se mund të nënshkruante formularët e vlerësimit. Pas kësaj, RH kishte nënshkruar këta formularë, së bashku me APO dhe AP.²¹

Gjetjet

Nuk ka dëshmi se IT dhe AP kanë kërkuar nga RH të nënshkruajë dokumentet me qëllim që të përfitojnë dobi pasurore për vete apo për ndonjë person tjetër (juridik). Sa i përket vlerësimit të dytë më datën 26/27 dhjetor 2007, nuk ka ndonjë dëshmi që mbështet dëshminë e APO, sepse RH ka deklaruar se ai me atë rast ka ardhur në zyrën e saj me dokumentet me vete dhe nuk është paraqitur ndonjë prove tjetër. Prandaj, të pandehurit janë liruar nga akuza e keqpërdorimit të detyrës zyrtare në pajtim me nenin 364 nën 1.1 e KPP.

Nga këto fakte, Trupi gjykues vjen deri te përfundimi se RH më datën 7 dhjetor 2007 ka nënshkruar formularët e vlerësimit pasi AP dhe IT e kanë bindur se nuk kishte ndonjë problem me nënshkrimin e dokumenteve edhe pse nuk kishte marrë pjesë në vlerësim. RH kishte filluar punën rishtas në Ministrinë e Shëndetësisë dhe nuk kishte përvojë në procedurat e prokurimit. Të pandehurit e dinin këtë. Duke përdorur mos-përvojën e saj ata kishin bindur atë të nënshkruajnë formularin e vlerësimit edhe pse nuk kishte marrë pjesë.

Duke nënshkruar formularin e vlerësimit RH ka falsifikuar një dokument zyrtar. Meqë kishte bërë këtë pasi i ishte thënë të bëjë një gjë të tillë nga IT dhe AP se nuk kishte asgjë të dëmshme në këtë veprim, ata kanë nxitur atë në falsifikim të dokumentit zyrtar.

Trupi gjykues, në pajtim me nenin 360 paragrafi 2 i KPK kualifikon veprimin e te pandehurve si nxitje në falsifikim të dokumenteve zyrtare në bashkë-kryerje në kundërshtim me nenin 348, paragrafi 1, të lexohet së bashku me nenin 23 dhe 24 të KPK.

Akuza 1.4

Nga arsyetimi i aktakuzës Trupi gjykues konkludon se veprimet janë kryer gjatë periudhës kohore në mes të datës 1 dhjetor 2007 deri më 27 dhjetor 2007.

¹⁷ Dosja 16C faqe 133 (SHQIP), Dosja 16A faqe 153-154 (ANG)

¹⁸ Dosja 16B faqe 176 (ANG) Dosja 16B faqe 180 (SHQIP)

¹⁹ Deklarata APO procesverbal nga shqyrtimi kryesor 14 mars 2013, faqe 10

²⁰ Deklarata RH procesverbal nga shqyrtimi kryesor 21 mars 2013, faqe 3

²¹ Deklarata APO procesverbal nga shqyrtimi kryesor 14 mars 2013 faqe 9 and 10; Deklarata RH procesverbal nga shqyrtimi kryesor 21 mars 2013, faqe 3; Deklarata IH, procesverbal nga shqyrtimi kryesor 16 maj 2013, faqe 13

Faktet e dëshmuara

AP, IT dhe BS, pronar i EX, janë takuar një herë në restaurant në dhjetor të vitit 2007.²² IH ka pasur kontakte me operatorët ekonomik në cilësinë e tij si zyrtar i prokurimit në Ministrinë e Shëndetësisë gjatë muajit dhjetor 2007.²³

Gjetjet

Kontaktet në mes të zyrtarëve të Ministrisë së Shëndetësisë dhe operatorëve ekonomik mund të jenë të papërshtatshme për shkak të natyrës së kontaktit ose për shkak se vetë kontakti është i ndaluar.

IH si zyrtar i prokurimit ka pasur kontakte të përditshme me operatorët ekonomik lidhur me ekzekutimin e kontratave të tyre dhe procedurave të tenderimit, për të cilat ai ka qenë personi kontaktues. Këto kontakte si të tilla kanë qenë të lejuara. Prokuroria nuk ka prezantuar ndonjë provë lidhur me përmbajtjen e këtyre kontakteve. Nuk ka dëshmi se kontaktet që ka pasur IH kanë qenë të papërshtatshme për shkak të natyrës së kontakteve. Meqë nuk mund të dëshmohen kontaktet e papërshtatshme në mes të IH dhe operatorëve ekonomik të përmendur, i pandehuri duhet të lirohet në pajtim me nenin 364 nën 1.1 të KPP.

Është e paqartë se kur ka ndodhur takimi në mes të IT, BS dhe AP. Kontaktet me operatorët ekonomik nuk janë të ndaluara për sekretarin permanent apo zyrtarin për furnizime. Një kontakt i tillë mund të jetë i ndaluar për një anëtar të komisionit për vlerësim të tenderit gjatë procesit të vlerësimit të tenderit në rastet kur ka nevojë zyrtare për një kontakt të tillë. Meqë nuk dihet natyra e kontaktit që të pandehurit kanë pasur me BS dhe nuk mund të vërtetohet se kontakti ka ndodhur gjatë kohës kur AP është caktuar anëtarë e komisionit për vlerësim të tenderit 71300/07/789/126, nuk ka dëshmi që të pandehurit kanë pasur kontakte të papërshtatshme me BS. Të pandehurit duhet të lirohen nga akuza për keqpërdorim të detyrës zyrtare në pajtim me nenin 364 nën 1.1 të KPP.

Akuza 1.5

Nga arsyetimi i aktakuzës Trupi gjykues konkludon se veprimi është kryer më apo rreth datës 26 dhjetor 2007.

Faktet e vërtetuara

AS, vëllai i BS, ka përdorur licencën e farmacistit të AP nga data 1 janar 2006 deri më 27 shkurt 2007 për kompaninë e tij VX.²⁴ AP është njohur me BS dhe ka organizuar një takim me të dhe IT.²⁵ Më 26 dhjetor 2007 AP është caktuar si anëtarë e komisionit për vlerësim të tenderit 71300/07/789/126. BS kishte bërë një ofertë në këtë tender.

Gjetjet

Sipas seksionit 5 të Kodit të Etikës të përpiluar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, konsiderohet se ka konflikt interesi kur zyrtari, ose ndonjë anëtar familjeje ose bashkëpunëtor i tij ka një interes aktual ose potencial financiar ose të llojit tjetër i cili dëmton ose mund të dëmtojë pavarësinë e gjykimit të zyrtarit gjatë kryerjes së detyrave ndaj

²² Deklarata AP, procesverbal nga shqyrtimi kryesor 16 maj 2013, faqe 43; Deklarata IT, Procesverbal nga shqyrtimi kryesor 24 maj 2013, faqe 43;

²³ Deklarata IH, Procesverbal nga shqyrtimi kryesor 16 maj 2013, faqe 4

²⁴ Dosja 62, faqe 8-17; Deklarata AP Procesverbal nga shqyrtimi kryesor 16 maj 2013, faqe 40;

²⁵ Deklarata BS, procesverbal nga shqyrtimi kryesor 27 mars 2013, faqe 16;

organizatës. Bashkëpunëtor konsiderohet, në mes tjerash, çdo ndërmarrje në të cilën ose me të cilën zyrtari ose ndonjë anëtar i familjes së tij/saj ka ndonjë lidhshmëri materiale.

Nuk është dëshmuar se BS është anëtar i familjes së AP. Nuk ka ndonjë provë që ajo (apo ndonjë anëtar i familjes së saj) ka pasur ndonjë interes, financiar apo tjetër, në kompaninë pronë e BS. Lidhja që ka pasur me vëllain e BS deri në shkurt të vitit 2007 nuk përbën konflikt interesi. E pandehura duhet të lirohet nga akuza e keqpërdorimit të detyrës zyrtare sipas KPP, sepse nuk është dëshmuar se ka pasur konflikt interesi.

Count 1.6

Faktet e vërtetuara

Në nëntor/dhjetor janë mbajtur takime në Ministrinë e Shëndetësisë lidhur me modalitetet e dorëzimit të furnizimeve pas mbylljes së vitit fiskal në mes të zyrtarëve dhe operatorëve ekonomik. Gjatë këtyre takimeve është diskutuar se si mund të përdoret buxheti për mallrat që nuk kanë mundur të dorëzohen para përfundimit të vitit fiskal më 21 dhjetor 2007. Në një apo më shumë takime të tilla kanë marrë pjesë IT, AP, EM, HE, Shefi i Farmacisë dhe operatorët ekonomikë.²⁶ Operatorët ekonomikë i kanë dorëzuar garanci bankare Ministrisë së Shëndetësisë, në mënyrë që të paguhen paraprakisht për mallrat që nuk kanë mundur të dorëzohen para 21 dhjetorit 2007.²⁷

Sipas rekomandimit të AP formularët e pranimit për pranimin e mallit në Depon Qendrore në Mazgit janë nënshkruar, edhe pse mallrat nuk ishin dorëzuar.²⁸

Gjetjet

Asnjë nga dëshmitarët e paraqitur nga prokurori nuk ka dëshmuar para Trupit gjykues se AP ka luajtur ndonjë rol në vendimin për të përdorur garanci bankare. Edhe nëse ajo ka qenë personi që ka sugjeruar skemën e garancive bankare, ajo nuk ka qenë në pozitë të bëjë këtë. Si zyrtare farmaceutike nuk ka qenë përgjegjësi e saj të vendos mbi këtë çështje. Fakti që ajo ka qenë në dijeni për përdorimin e garancive bankare dhe si anëtare e komisionit pranues ka nënshkruar pranimin e mallrave që nuk janë dorëzuar nuk e ndryshon këtë opinion. E pandehura lirohet nga akuza për keqpërdorim të pozitës zyrtare sepse nuk ka prova për të dëshmuar akuzën.

Duke i thënë anëtarit të komisionit të pranimit se ajo duhet të nënshkruajë formularët e pranimit edhe pse mallrat nuk ishin dorëzuar, AP e ka nxitur të kryejë veprën penale të Falsifikimit të dokumenteve zyrtare, sepse informacionet në dokumente, që tregonin se mallrat ishin pranuar, nuk ishin të vërteta.

Veprimi i përshkruar në akuzën 1.6 të aktakuzës nuk mund të ri-kualifikohet si Mashtrim në detyrë, sepse sipas akuzës AP i ka thënë komisionit për pranim të nënshkruajë dhe ajo vetë nuk e ka nënshkruar formularin e pranimit.

²⁷ EM, Procesverbal nga shqyrtimi kryesor 13 mars 2013, faqe 9, Procesverbal nga shqyrtimi kryesor 14 mars, faqe 2; Deklarata APO, Procesverbal nga shqyrtimi kryesor 14 mars, faqe 11; Deklarata LM, Procesverbal nga shqyrtimi kryesor 28 shkurt 2013, faqe 14, Procesverbal nga shqyrtimi kryesor 22 shkurt 2013, faqe 11; Deklarata LM, Procesverbal nga shqyrtimi kryesor 22 mars 2013, faqe 2;

²⁷ LM, Procesverbal nga shqyrtimi kryesor 22 mars, faqe 3; BS, Procesverbal nga shqyrtimi kryesor 27 mars 2013, faqe 18;

²⁸ APO, Procesverbal nga shqyrtimi kryesor 14 mars 2013, faqe 12; NZ, Intervistë në polici, Dosja 16B faqe 78-79; Dosje e nënshkruar e listës së paketimit 16b, faqe 232; Raportet e pranimit dhe inspektimit, Dosja 58, faqe 97-100;

Edhe pse IT si Sekretar permanent ka pasur përgjegjësinë finale mbi përdorimin e garancive bankare, ai nuk është akuzuar për faktin se ai ka aprovuar apo ka marrë një vendim të tillë. Ai ka marrë pjesë në një apo disa takime lidhur me këtë çështje, por, kjo në vetvete nuk përbën veprë penale të Keqërdorimit të detyrës zyrtare. Prandaj, i pandehuri lirohet.

Për më shumë, nuk ka prova se vendimi për të përdorur garancitë bankare është marrë me qëllim të përfitimit të paligjshëm të dobisë pasurore. Të gjithë personat e përfshirë në takimet lidhur me garancitë bankare kanë deklaruar se qëllimi ka qenë të shpenzohet sa më shumë që ka qenë e mundur nga buxheti vjetor. Fakti që si rezultat i përdorimit të garancive bankare operatorë të caktuar ekonomikë kanë përfituar –pagesë për mallra të cilat nuk i kanë dorëzuar- nuk dëshmon se ky ka qenë qëllimi i përdorimit të garancive bankare. Fakti që Ministria e Shëndetësisë është dëmtuar për shkak se disa nga mallrat që në fund janë dorëzuar kanë qenë të një origjine tjetër nga ajo që është përshkruar në ofertën e tenderit nuk është pasojë e përdorimit të garancive bankare, por e neglizhencës së komisionit që ka pranuar këto mallra kur ato janë dorëzuar.

Akuza 1.7

Nga arsyetimi i aktakuzës, Trupi gjykues konkludon se ngjarjet e përshkruara nën akuzën 1.6 kanë ndodhur në mes të datës 1 qershor 2010 dhe 30 nëntor 2010.

Faktet e vërtetuara

Në vitin 2009 JX dhe YX kanë nënshkruar të ashtuquajturat kontratat 1+1 me Ministrinë e Shëndetësisë. Këto kanë qenë kontrata një vjeçare me mundësi vazhdimi edhe për një periudhë tjetër maksimalisht deri në 1 vit. Në qershor të 2010 ishin organizuar takime për operatorët ekonomik në Ministrinë e Shëndetësisë me BB, IT dhe zyrtarë të Ministrisë.²⁹ Gjatë takimit me përfaqësuesit e JX, FC dhe YX, AG, është diskutuar se ata kishin ngritur padi kundër Ministrisë së Shëndetësisë dhe se kjo mund të parandalonte vazhdimin e kontratave të tyre.³⁰ Kontratat e vazhduara të YX dhe JX ishin përgatitur dhe nënshkruar nga EM. Nënshkrimi i tij mban datën 30 qershor 2010.³¹ Këto kontrata nuk janë nënshkruar nga HK dhe BB. Të gjitha kontratat e vazhduara janë të nënshkruara nga HK si sekretar permanent dhe BB.³² Kontratat e YX dhe JX nuk ishin vazhduar.

Në vitin 2009, pasi kishte marrë informacione nga njëra nga institucionet shëndetësore, Inspektorati Shëndetësor kishte marrë mostra të shurupit të paracetamolit të furnizuar nga JX-i për analiza të mëtuqjeshme.³³ Për shkak se paracetamoli nuk ishte në pajtim me standardet JX-i tërhoqi sasinë e paracetamolit nga depoja e Ministrisë së Shëndetësisë. Në maj të vitit 2010 BF kërkoi nga JX të zëvendësoje sasinë e paracetamolit. Më 30 qershor 2010 IT kishte dërguar një e-mail HE duke kërkuar nga ai të ndërmarrë veprime ndaj JX-it në pajtim me kompetencat e tij lidhur me paracetamolin.³⁴ Më 10 qershor 2010 JX kishte kërkuar licencë importi për të importuar paracetamol. Kjo kërkesë nuk ishte aprovuar sepse nuk ishte e qartë nëse ECX, prodhuesi i paracetamolit kishte të drejtë të prodhojë këtë medikament.³⁵ Më 17

²⁹ FC Procesverbal nga shqyrtimi kryesor 14 shkurt 2013, faqe 46; AG Procesverbal nga shqyrtimi kryesor 15 shkurt 2013, faqe 17; HK Procesverbal nga shqyrtimi kryesor 8 mars 2013 faqe 14; EM, Procesverbal nga shqyrtimi kryesor 13 mars 2013 faqe 13;

³⁰ FC, Procesverbal nga shqyrtimi kryesor 14 shkurt 2013, faqe 47; AG, Procesverbal nga shqyrtimi kryesor 15 shkurt 2013;

³¹ Kontratë JX Dosja e provave shtesë 1 faqe 150-172; Kontratë YX Dosja e provave shtesë 1 faqe 178-186

³² Dosja e provave shtesë 1, faqe 187 -274

³³ Dosja e provave e prezantuar nga IT, tab 15 Listë distribuimi e datës 13 tetor 2009

³⁴ Dosja 32, faqe 235;

³⁵ Dosja 33, faqe 144

qershor 2010 BB kishte bërë një kallëzim penal për parregullsitë brenda Ministrisë së Shëndetësisë lidhur me paditë civile të ngritura nga JX dhe YX.³⁶ Më 19 nëntor 2010 IT kishte bërë një parashtrësë pothuajse identike.³⁷

Gjetjet

HF nuk ka punuar në Ministrinë e Shëndetësisë gjatë kohës në fjalë. Prandaj, akuza kundër tij nuk mund të vërtetohet.

As akuza e as arsyetimi nuk specifikojnë ndonjë veprim apo përfshirje të AP, ZK apo BF. Asnjë nga veprimet nuk mund të vërtetohen kundër këtyre të pandehurve lidhur me këtë akuzë. Prandaj, këta të pandehur lirohen.

Trupi gjykues vëren se sipas kushteve të kontratave të lidhura në mes të Ministrisë së Shëndetësisë dhe, JX dhe YX, nuk ka pasur obligim kontraktual që kontratat të vazhdohen.

Nga deklaratat e dhëna nga dëshmitarët dhe të pandehurit mbetet e paqartë se përse kontratat e YX dhe JX nuk janë vazhduar deri në qershor të 2010. BB ka deklaruar se ai ka nënshkruar të gjitha kontratat që i shin sjellë atij nga HK.³⁸ HK ka deklaruar se i kishte sjellur të gjitha kontratat BB pasi i kishte nënshkruar ai. Pasi kontratat i ishin sjellur prapë atij ai kishte vërejtur se dy ishin të panënshkruara, por, nuk kishte kërkuar shpjegime nga BB.³⁹ Deklarata e dhënë nga HK është në kundërshtim me nënshkrimet në kontratat në fjalë. Ato janë të nënshkruara vetëm nga EM. Nënshkrimi i z. EM mban datën 30 qershor 2010. Vetëm njëra nga kontratat e panënshkruara është e vulosur.

IT si këshilltar personal i Ministrit të Shëndetësisë nga prilli 2010 deri në korrik 2010 nuk ka qenë në pozitë të vendosë mbi vazhdimin e kontratave. Edhe pse dëshmitarët kanë deklaruar se ai ka pasur shumë ndikim në BB, këto pretendime nuk janë provuar. Nuk është e qartë se në çfarë bazohen këto pretendime. Nga këto deklarata nuk mund të arrihet deri te ndonjë konkludim.

Edhe pse edhe FC edhe AG kanë dëshmuar se paditë e ngritura nga kompanitë e tyre janë diskutuar gjatë takimeve me operatorët ekonomik, kjo nuk mjafton që të konkludohet se kontratat e tyre nuk ishin vazhduar për shkak të këtyre padive.

Provat e prezantuara nuk janë bindëse sa i përket asaj se kush ka vendosur që kontratat e JX dhe YX mos të vazhdohen. Rrethanat tregojnë se ka një raport në mes të padive të ngritura nga këto kompani dhe faktit që kontratat e tyre nuk janë vazhduar, por kjo nuk mjafton për të dëshmuar përtej dyshimit të arsyeshëm se BB dhe IT janë përgjegjës për mos-vazhdimin e kontratave.

Nga provat është e qartë se JX ishte vizituar nga Inspektorati Shëndetësor para se IT dhe BB kanë filluar punën në Ministri nga prilli 2010. Pos e-mail-it të datës 30 qershor 2010, ku IT në emër të Ministrit ka kërkuar të dhëna për JX-in dhe kërkon që të ndërmerren veprime nëse është e nevojshme, nuk ka prova se IT dhe/ose BB kanë kërkuar ose urdhëruar Inspektoratin të ndërmarrë masa kundër JX-it.

³⁶ Kallëzim penal i datës 17 qershor 2010, Dosja 35, faqe 13; Dosja 32, faqe 110; Dosja 38, faqe 15; Dosja 43, faqe 50; Dosja 47, faqe 107;

³⁷ Parashtrësë 19 nëntor 2010, Dosja 47, faqe 107; Dosja 35, faqe 3;

³⁸ BB, Procesverbal nga shqyrtimi kryesor 17 maj 2013, faqe 27;

³⁹ HK, Procesverbal nga shqyrtimi kryesor, 8 mars, faqe 19;

Nuk janë paraqitur prova të cilat do të dëshmonin se, pos liçencës së importit për paracetamol që nuk ishte aprovuar për shkak se kishte paqartësi mbi autorizimin e prodhuesit, janë refuzuar apo vonuar liçenca të tjera importi apo eksporti për shkak se të pandehurit kanë ndikuar në vendim-marrjen lidhur me këto liçenca. Për shkak të mungesës së Shefit të Agjencisë Kosovare të Produkteve Medicinale kishte pasur grumbullim të kërkesave për lëshim të liçencave. Jo vetëm YX dhe JX-i por edhe kompanitë e tjera kanë pësuar nga mungesa e zyrtarëve kompetent.

Ngjarjet që kanë përfshirë YX dhe JX nuk mund të konsiderohet të jenë rezultat i një fushate kundër këtyre kompanive. Trupi gjykues nuk ka arritur të vërtetojë përfshirjen e IT dhe BB në këto ngjarje në shkallë të atillë që do të përbënte tejkallim të ekzekutimit të zakonshëm të detyrave dhe kompetencave të tyre. Prandaj, të pandehurit lirohen nga veprimet e përshkruara në akuzën 1.7.

Akuza 1.8

Faktet e vërtetuara

Trupi gjykues i referohet ngjarjeve të vërtetuara nën akuzën 1.7 lidhur me vazhdimin e kontratës së JX-it dhe YX.

Gjetjet

Duke u referuar fakteve të vërtetuara dhe arsytimit nën akuzën 1.7, lidhur me vazhdimin e kontratave të JX-it dhe YX, të pandehurit duhet të lirohen sepse nuk mund të dëshmohet se kontratat e JX-it dhe YX nuk janë vazhduar për shkak të vendimeve të marra nga BB dhe i ndikuar nga IT.

Akuza 1.9

Faktet e vërtetuara

Më 2 mars 2011 ishte shpallur një tender me numër 206/11/029/111. Loti 20 i këtij tenderi ishte për penj kirurgjikal. Pozicionet 5 dhe 6 ishin për penj poliglaktinë 910.⁴⁰ Ofertat për këtë tender ishin dorëzuar nga JX, LX dhe kompani të tjera. Më 28 mars 2011 formulari për vlerësim i tenderit për lot-in 20 ishte nënshkruar nga ana e komisionit për vlerësim. Sipas këtij vlerësimi JX kishte qenë ofertuesi më i lirë i përgjegjshëm. Ky formular vlerësimi nuk ishte nënshkruar nga shefi i departamentit të prokurimit, ZK.⁴¹ Më 14 prill 2011, lot-i 20 ishte ri-vlerësuar. Sipas këtij vlerësimi ofertuesi më i lirë i përgjegjshëm për këtë lot ka qenë LX pasi disa ofertues ishin eliminuar sepse në katalogjet e tyre nuk gjendeshin të gjithë penjtë e kërkuar.⁴²

Gjetjet

Formulari i vlerësimit i tenderit i datës 30 mars 2011 i ishte dhënë prokurorisë nga BM. Gjatë intervistimit të tij nga Prokurori ai fillimisht ka deklaruar se e ka gjetur këtë dokument gjatë kohës kur ZK nuk ka qenë në zyrën e tij. Më vonë ai ka pranuar se ky dokument nuk ishte dorëzuar nga ai dhe se e ka mbajtur në zyrën e tij.⁴³ Ai po ashtu ka shtuar një memorandum, të adresuar ZK, në dosjen e tenderit ku ka deklaruar se është mbështetur në ekspertizën e

⁴⁰ Njoftimi për kontratë Dosja 42 faqe 79-98;

⁴¹ Formulari për vlerësim i tenderit Dosja 42 faqe 26;

⁴² Formulari për vlerësim i tenderit Dosja 42 faqe 39;

⁴³ BM, Procesverbal nga shqyrtimi kryesor 21 shkurt, faqe 30

anëtarëve të tjerë të panelit lidhur me vlerësimin e katalogjeve.⁴⁴ Ky memorandum kurrë nuk i ishte dërguar ZK.⁴⁵

BM ka dëshmuar duke thënë se arsyeja për ri-vlerësim të tenderit ka qenë fakti që JX ishte vlerësuar si ofertuesi më i lirë i përgjegjshëm. Meqë kjo kompani nuk i pëlqente IT, atij i është thënë nga ZK, HF dhe BF se vlerësimi duhej të përsëritej.

BF ka qenë anëtar i komisionit vlerësues. Ai ka deklaruar se gjatë vlerësimit të parë të bërë nga komisioni katalogët nuk ishin kontrolluar. Për këtë arsye duhej të bëhej ri-vlerësimi.⁴⁶

HF si anëtar i komisionit për vlerësim ka deklaruar se ofertat ishin ri-vlerësuar sepse.⁴⁷

ZK ka mohuar se i ishte dhënë ndonjëherë formulari i parë vlerësues për t'a nënshkruar. Ai është në dijeni vetëm për formularin e dytë vlerësues, të cilin e ka nënshkruar.⁴⁸

Trupi gjykues ka urdhëruar një ekspertizë për të vlerësuar katalogët e prezantuar nga JX-i dhe LX-i.⁴⁹ Sipas raportit nga ekspertiza penjtë nën pozicionin 5 dhe 6 në lot-in 20, janë gjetur në katalogun e LX-it por jo edhe në atë të JX-it. Gjatë ekzaminimit nga ekspertët është qartësuar se këta penj nuk janë gjetur as në katalogun e LX-it, por, penjtë e prezantuar në katalogun e LX-it ishin pothuajse identik. Sipas ekspertëve dallimi në mes të Poliglaktinë 910 dhe Acidit Poliglikolik nuk është domethënës dhe ata mund të zëvendësohen me njëri tjetrin.

Trupi gjykues nuk ka gjetur prova lidhur me pretendimin se IT ka udhëzuar komisionin vlerësues për të mos i dhënë tenderin JX-it. Edhe pse nga provat e prezantuar rrjedh dyshimi se IT nuk pëlqente JX-in sepse ata kishin fituar padinë në vlerë prej 1.5 milion euro, kjo nuk është e mjaftueshme për të vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm se ai ka përdorur pozitën e tij për të parandaluar JX-in në fitimin e këtij apo tenderëve të tjerë. Nuk ka prova që vërtetojnë se IT në ndonjë mënyrë ka ndërhyrë në vlerësimin e tenderit. Fakti që ai ka informuar BB në maj, pasi është dërguar njoftimi mbi dhënien e kontratës, nuk vërteton përfshirjen e tij përpara kësaj faze.

Deklarata që BM ka dhënë lidhur me ri-vlerësimin nuk mbështetet me provat e tjera. Fakti që ai fillimisht ka thënë se kishte gjetur vlerësimin e parë në zyrën e ZK dhe më vonë ka pranuar se e kishte marrë nga dosja bën deklaratën e tij më pak të besueshme. E njëjta vlen edhe për memorandumin e adresuar ZK, por që nuk i ishte dërguar kurrë. Ri-vlerësimi i bërë për shkak se katalogët nuk ishin kontrolluar siç duhet, i jep atij madje motiv për të vepruar, për shkak se ishte përgjegjës për ndjekje të mirëfilltë të rregullave të prokurimit.

Edhe pse deklaratat e HF dhe BF dallojnë lidhur me arsyet për ri-vlerësim, mbetet e paqartë se çfarë ka ndodhur pas vlerësimit të parë dhe kush mbante përgjegjësinë për këtë. Meqë nuk mund të vërtetohet se HF dhe BF kanë bindur BM të ri-vlerësojë ofertat, ata duhet të lirohen.

⁴⁴ Dosja 41, Tab 28

⁴⁵ BM, Procesverbal nga shqyrtimi kryesor 21 shkurt, faqe 7

⁴⁶ BF, Procesverbal nga shqyrtimi kryesor, faqe 15-16

⁴⁷ Deklaratë HF Procesverbal nga shqyrtimi kryesor 22 maj, faqe 19;

⁴⁸ Deklarata ZK Procesverbal nga shqyrtimi kryesor 24 maj faqe 6;

⁴⁹ Raport i ekspertit i datës 13 maj 2013

Nuk ka prova se ri-vlerësimi i parë i është prezantuar ZK, pos deklaratës së BM. Meqë ZK mohon faktin që me qëllim nuk ka nënshkruar deklaratën sepse i ishte dhënë JX-it, nuk mund të vërtetohet se ai ka keqpërdorur pozitën e tij zyrtare dhe prandaj duhet të lirohet.

Akuza 1.10

Faktet e vërtetuara

Më 26 korrik 2010 ishte shpallur një tender me numër 71300 10 533 111 në të cilin ishin përfshirë tabletat Fludarabine (lot-i 26).⁵⁰ Tenderi për këtë lot (26) ishte anuluar më 27 tetor 2010, sepse kishte vetëm një ofertues.⁵¹ Më 29 tetor 2010 ky medikament ishte ri-tenderuar nën numër të njëjtë tenderi, numri i lot-it 26.⁵² Më 26 nëntor 2010 tenderi për këtë lot ishte anuluar sepse kishte më pak se 3 ofertues.⁵³ Ky medikament ishte tenderuar në tenderin me numër 71300 10 647 111 më 30 nëntor 2010, numri i lot-it 29.⁵⁴ Tenderi për këtë lot ishte anuluar më 2 mars 2011, për shkak të mungesës së tre ofertuesve.⁵⁵ Medikamenti ishte tenderuar në datën e njëjtë si lot-i 11 në tenderin me numër 206 11 029 111.⁵⁶ Më 22 korrik 2011 medikamenti ishte tenderuar në tenderin 206 11 098 111, lot-i 4.⁵⁷ I njëjti ishte anuluar për shkak të mungesës së ofertuesve të përgjegjshëm më 8 dhjetor 2011.⁵⁸

Më 12 nëntor 2010 ishte shpallur një tender për beta interferon nën numrin e prokurimit 71300 10 601 111. Ky tender ishte anuluar më 30 nëntor 2010. Më 5 shkurt 2011 ishte shpallur tender për beta interferon 1b nën numrin e tenderit 106 10 017 111. Kontrata për këtë tender i ishte dhënë SX si ofertuesit më të lirë të përgjegjshëm.

Më 31 dhjetor 2010 Ministria e Shëndetësisë ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Prokurimit Publik për revokim të nenit 30A.4 të Ligjit mbi Prokurimin Publik. Kjo kërkesë ishte refuzuar më 2 shkurt 2011. Më 4 shkurt 2011 ZK kishte parashtruar kërkesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit për të shqyrtuar këtë vendim.⁵⁹ Kjo kërkesë ishte refuzuar si e pabazuar nga Organi Shqyrtues i Prokurimit më 28 shkurt 2011.⁶⁰

Gjetjet

BF, si shef i departamentit farmaceutik, nuk ka pasur autoritet zyrtar të shpallë apo anulojë tenderë. Kjo bëhet nga ana e departamentit të prokurimit. Prokuroria nuk ka prezantuar asnjë provë se BF në ndonjë mënyrë ka ndikuar në ndonjë vendim për të shpallur apo anuluar ndonjë tender, pos që ka prezantuar nevojat e institucioneve shëndetësore departamentit të prokurimit në mënyrë që të organizohen tenderë për produktet e nevojshme, nëse nuk ka pasur kontrata për këto produkte. Meqë nuk është vërtetuar se BF ka shfrytëzuar pozitën e tij për të ndikuar në procedurat e tenderimit, ai lirohet nga veprimi i përshkruar nën akuzën 1.10 të aktakuzës, sepse veprimi nuk mund të vërtetohet.

⁵⁰ Dosja e njoftimit mbi kontratën 44, faqe 72;

⁵¹ Dosja e njoftimit mbi anulimin 44, faqe 80;

⁵² Dosja e njoftimit mbi kontratën 44, faqe 91;

⁵³ Dosja e njoftimit mbi anulimin 44, faqe 97;

⁵⁴ Dosja e njoftimit mbi kontratën 44, faqe 100;

⁵⁵ Dosja e njoftimit mbi anulimin 44, faqe 111;

⁵⁶ Dosja e njoftimit mbi kontratën 44, faqe 124

⁵⁷ Dosja e njoftimit mbi kontratën 44, faqe 153

⁵⁸ Dosja e njoftimit mbi anulimin 44, faqe 161

⁵⁹ Ankesë kundër vendimit të APP-së, Dosja 33, faqe 28

⁶⁰ Vendimi APP, Dosja 33, faqe 60

ZK, si shef i departamentit të prokurimit ka qenë përgjegjës për shpalljen dhe anulimin e tenderëve. IT, si menaxher i drejtpërdrejtë i tij, është dashur të aprovojë shpalljen e tenderëve; nuk ka prova se ai ka qenë i përfshirë në anulimin e tenderëve.

Arsyeja për anulim të tenderëve për Fludarabine ka qenë mungesa e ofertuesve të përgjegjshëm, siç shihet nga shënimet mbi anulimin. Nuk janë prezantuar prova që vërtetojnë se kjo arsye është jo valide dhe se në fakt ka pasur mjaft ofertues të përgjegjshëm, por, zyrtarët e përfshirë nuk kanë dashur t'i japin kontratën kompanisë së MA. Prandaj, pretendimet se tenderët janë anuluar për arsye të pabazuara nuk mbështeten me prova. Në raste të ngjashme tenderuese, po ashtu janë anuluar edhe tenderë të tjerë për shkak të mungesës së ofertuesve të përgjegjshëm.

Pretendimet se nuk ishte bërë kërkesë për revokim të nenit 30A.4 të Ligjit mbi Prokurimin Publik (20/L-99) është i pabazuar. Nga faktet e vërtetuara është e qartë se një kërkesë e tillë ishte bërë nga ZK, por që ishte refuzuar edhe nga APP edhe nga OSHP.

Deklarata e dhënë nga EM se tenderi për Interferon Beta ishte anuluar përpara se të hapeshin ofertat nuk mbështetet nga provat materiale. Deklarata e dhënë nga MA se tenderi për Interferon Beta ishte anuluar për shkak se IT kishte vendosur ashtu sepse ai nuk ka dashur që asnjëra nga kompanitë që kishin marrë dosjen e tenderit t'a fitojnë atë, nuk konsiderohet si e mbështetur, sepse ai pohon se këtë e kishte dëgjuar nga EM.

Dosja e lëndës e dorëzuar nga prokurori nuk përmban ndonjë dokument lidhur me procedurat e tenderimit mbi tenderët për Interferon beta. Prandaj, nuk mund të vërtetohet se ky tender është shpallur dhe anuluar pa arsye të bazuar.

Prokuroria nuk ka ofruar asnjë provë lidhur me qëllimin për të përfituar dobi pasurore për të pandehurit apo të tjerët apo lidhur me qëllimin për të dëmtuar personin e tretë. Fakti që pacientët mund të kenë vuajtur nga mungesa e medikamenteve, nuk vërteton se të pandehurit kanë vepruar me këtë qëllim.

Veprimet nën akuzën 1.10 nuk mund të vërtetohen lidhur me ZK dhe IT dhe, prandaj, ata lirohen nga pikat e kësaj akuze.

Akuza 1.11

Faktet e vërtetuara

Më 9 dhjetor 2009 FL nënshkroi të ashtuquajturën 1+1 kontratë me Ministrinë e Shëndetësisë për furnizim me infuzione intravenoze. Më 22 nëntor 2010 IT aprovoi zgjatjen e kësaj kontrate.⁶¹ Kontrata ishte përgatitur dhe nënshkruar nga kreu i prokurimit, sekretari i përhershëm dhe Ministri i Shëndetësisë më 22 nëntor 2010.⁶² Më 9 dhjetor 2010 infuzionet intravenoze ishin tenderuar në tenderin me numër 71300/10/647/111. Pas vlerësimit të ofertave për këtë tender, EX i ishte dhënë kontrata për këto produkte. Me krahasimin e çmimeve që ishin në kontratën e FL dhe çmimet që ofroi EX, del se çmimet e EX ishin më të

⁶¹ Dosja prova Shtese 2, faqe 3

⁶² Dosja prova Shtese 2, faqe 117

larta. Pak para kohës së vazhdimit të kontratës së FL, HF kërkoi ryshfet nga ai për vazhdimin e kontratës.⁶³

Konstatimet

ZK ishte emëruar Shef i Prokurimit me 27 dhjetor 2010, Vendimi për zgjatjen e kontratave 1+1 të nënshkruara në 2009 ishte marrë në nëntor të 2010-tës. Gjate asaj kohe ZK nuk ishte duke punuar në Ministrinë e Shëndetësisë kështu që ai nuk mund të jetë fajtor për veprën e përshkruar nën akuzën 1.11.

Gjykata e pranon deklaratën e dhënë nga FL se nga ai ishte kërkuar një përqindje në mënyrë që atij t'i vazhdohet kontrata. HF pranoi se ai u takua me FL. Deklarata e dhënë nga dëshmitari konsiderohet të jete e besueshme, sepse mbështetet nga deklaratat e BEB⁶⁴ dhe CG⁶⁵, të cilëve ai u tha, pak pasi ai e vizitoi HF, se çka ishte diskutuar gjate atij takimi. BEB dhe CG dhanë deklaratat e tyre pavarësisht nga njeri me tjetrin.

Fakti se FL ishte kërkuar të paguajë përqindje të cilën ai e refuzoi ta bëjë, nuk nënkupton se kontrata e tij nuk ishte vazhduar për këtë shkak. Për këtë konkluzion është me rëndësi fakti se data e kësaj bisede nuk dihet si dhe nuk dihet nëse IT e aprovoi vazhdimin dhe nënshkrimin e kontratës para apo pas kësaj date. Gjithashtu nuk është vërtetuar nëse HF vepronte në emër të IT.

Pasi që HF nuk ishte në pozitë të japë apo refuzojë kontrata, nuk mund të përjashtohet se ai e dinte se kontrata do të vazhdohej dhe kërkoi ryshfet për përfitim personal. Përmes provave nuk është bërë e qartë nëse FL në fakt ishte ftuar në Ministri ta nënshkruajë kontratën apo jo.

Pretendimet se IT e autorizoi shkëputjen (Gjykata: mos-vazhdimin) e kontratës të cilën FL e kishte me Ministrinë e Shëndetësisë nuk mbështeten nga asnjë provë. Në të kundërtën, propozimi i bërë nga BF dhe EM në lidhje me atë se cilat kontrata do të ishin vazhduar është aprovuar nga IT.

Duke pasur parasysh se akuzat nuk mund të vërtetohen të pandehurit lirohen.

Akuza 1.12

Faktet e vërtetuara

Më 27 janar 2011 ofertat e AX, KWX dhe KX në tenderin 206/11/009/136 ishin hapur nga komisioni e përbërë nga BEB, AA dhe ES.⁶⁶ Tenderi ishte vlerësuar nga AT, BM dhe FM si anëtarë të komisionit vlerësues.⁶⁷ Pas vlerësimit të ofertave të tyre ky tender iu dha AX si ofertuesi me i lire i përgjegjshëm.⁶⁸ HF ishte duke punuar për AX deri sa nuk filloi të

⁶³ FL, Procesverbal I Shqyrtimit Kryesor të 21 Shkurtit 2013, faqe 20;

⁶⁴ BEB, Procesverbal I Shqyrtimit Kryesor të 7 Marsit 2013, faqe 11;

⁶⁵ CG, Procesverbal I Shqyrtimit Kryesor të 8 Marsit 2013, faqe 4;

⁶⁶ Procesverbali i hapjes së tenderëve Dosja 45 faqe 309

⁶⁷ Raporti mbi vlerësimin e Tenderëve Dosja 45 faqe 106-110

⁶⁸ Raporti mbi vlerësimin e Tenderëve Dosja 45 faqe 106-110

punonte në Ministrinë e Shëndetësisë më 10 nëntor 2010. Autorizimi i tij që ai të veprojë në emër të AX nuk ishte hequr kurrë nga regjistrat e Odës Ekonomike.

Konstatimet

Prokuroria nuk prezantoi asnjë provë të vërtetojë pretendimet se tre ofertuesit AX, KX dhe KWX kishin kurdisur çmimet e tyre.

Asnjë veprim i IT nuk përfshihet në aktakuzë. Ai nuk ishte i kyçur në procesin e tenderit dhe se nuk e ka bashkë-nënshkruar kontratën me AX. Fakti se i pandehuri është informuar pas përfundimit të procesit të tenderit për konflikt interesi në lidhje me këtë tender sepse HF ishte i kyçur në këtë kompani para se ai t'i bashkohej Ministrinë e Shëndetësisë nuk vërteton se ai ishte në dijeni për këtë gjë para se të shpallej tenderi. I pandehuri pra duhet liruar pasi që nuk ka prova se ai e ka shpërdorur pozitën e tij zyrtare.

Gjithashtu asnjë veprim i kryer nga HF nuk përshkruhet në aktakuzë. Pasi që ai nuk ishte i përfshirë në procedurat e prokurimit ai nuk do të mund të kontrollonte asnjë dokument që të vërtetojë nëse ka pasur konflikt interesi apo jo. Nuk ka prova se ai në ndonjë mënyre kishte influencuar komisionin e vlerësimit. I pandehuri duhet të lirohet pasi që nuk është vërtetuar se ai ka përdorur pozitën e tij për të ju dhënë tenderi AX.

ZK si Shef i departamentit të Prokurimit ka pasur të drejtë që t'i marrë parasysh rekomandimet e dhëna nga komisioni i vlerësimit. Ai nuk ka qenë i obliguar të kontrollojë në detaje vlerësimin i cili ishte bërë. Nuk është provuar nëse ai ka qenë në dijeni ose jo për ndonjë lidhje në mes të HF dhe AX.

Akuza 1.13

Në bazë të aktakuzës Gjykata konstaton se vepra është kryer në mes të 13 Korrikut 2011 dhe 12 Janarit 2012.

Faktet e vërtetuara

Gjatë bastisjes në Ministrinë e Shëndetësisë një dosje me dosjen e tenderit 20611095111 ishte marrë nga policia.

Konstatimet

Dosja në fjalë si e tillë nuk ishte dorëzuar në Gjykatë, edhe pse dosja e lendes përmban dokumentacion që i përket këtij tenderi. Gjykata nuk mund të konstatojë se mungojnë dokumente nga dosja e Tenderit. Sidoqoftë gjykata konstaton se ishte bërë një ankese tek Organi Mbikëqyrës i Prokurimit nga operatori ekonomik SX në lidhje me shortet 72 dhe 73 në këtë tender. Organi Mbikëqyrës i Prokurimit në vendimin e tij nuk bënë ndonjë vërejtje në lidhje me dokumentet që mungojnë. Nuk ka prova të mjaftueshme se i pandehuri ZK nuk i kishte ruajtur dokumentet e tenderit.

Për më tepër prokurori nuk prezantoi asnjë provë që të provoj qëllimin me të cilin i pandehuri ishte duke vepruar. Për arsyet e cekura më lart vepra penale nuk mund të provohet. I pandehuri duhet të lirohet.

Akuza 2

Faktet e vërtetuara

Më 30 nëntor 2007 një takim ishte mbajtur në mes to AP, EM dhe LM si zyrtarë të Ministrisë e Shëndetësisë dhe BD si përfaqësues i JX. Takimi ishte thirrur me kërkesë të AP. Gjatë këtij takimi AP kishte kërkuar nga BD që të tërheqë padinë e tij kundër Ministrisë së Shëndetësisë për shkelje të kontratës. BD i ishte ofruar një tender prej 70.000 Eurosh në shkëmbim të tërheqjes së padisë. Atij gjithashtu i ishte premtuar ndihmë në tenderët e ardhshëm. Kur BD refuzoi të tërheqë padinë, AP doli nga takimi dhe u kthye me IT. Pasi atij iu tha se BD i ishte kërkuar të tërheqë padinë ai tha se ata nuk po kërkonin asgjë. Ai i tha BD se ka më shumë gjasa që Kosova të jetë nën Serbi se sa ai të fitojë me padinë e tij. Ai gjithashtu i tha atij se JX nuk do të fitoj asnjë tender përderisa ai është në detyrë.⁶⁹

Konstatimet

Nuk ka prova se IT e kishte autorizuar ofertën e bërë BD që ai të tërheqë padinë e tij. Edhe pse nuk ngjan sikur ai nuk e dinte për këtë takim dhe për qëllimin e këtij takimi, kjo nuk është e mjaftueshme të provojë se ai si bashkë-kryerës ishte i përfshirë në këtë akt. Deklarata e tij tek BD mund të konsiderohet si sjellje joprofesionale, porse nuk përben shpërdorim të detyrës zyrtare. Kështu që IT duhet liruar nga veprat e përshkruara në pikën 2.

Edhe pse sipas deklaratave të disa dëshmitareve ishte AP ajo e cila i kishte ofruar BD tender nëse ai do ta tërhiqte padinë, ajo nuk ishte në pozitë ta bënte atë. Ajo ishte zyrtare për furnizim dhe nuk ishte e përfshirë në tender veç nëse ishte e caktuar si anëtar e panelit. Si e tillë ajo nuk do mund t'i jepte tender operatorit ekonomik vetvetiu. Sipas deklaratës së LM takimi ishte thirrur nga EM sipas propozimit të Gjykatës në mënyrë që të mbërrihet një ujudi Gjyqësore për lëndën. Nuk ka prova nëse AP ishte e përfshirë në procedurat gjyqësore në lidhje me padinë e JX. Gjykata konstaton se nuk do të kishte gjasa që ajo të udhëheqtë një takim me dy drejtorë. Asnjë provë nuk u prezantua se ajo në ndonjë mënyrë ishte e autorizuar ta bëjë këtë.

Provat e ofruara nga Prokuroria janë të pamjaftueshme që të vihet në konkludim se AP i premtoi BD tender në shkëmbim të tërheqjes së padisë kështu ajo lirohet nga veprat e përshkruara në pikën 2.

Akuza 3

Faktet e vërtetuara

⁶⁹ ⁶⁹ Deklarata e BD, procesverbali i Shqyrtimit Kryesor më 13 Shkurt 2013, faqe 7, ⁶⁹ Deklarata e LM, procesverbali i Shqyrtimit Kryesor më 22 Shkurt 2013, faqe 12-13, ⁶⁹ Deklarata e EM, procesverbali i Shqyrtimit Kryesor më 13 Mars 2013, faqe 7 dhe 8;

Në Qershor të vitit 2010 ishin mbajtur takime në Ministrinë e Shëndetësisë me operator ekonomik që e furnizonin Ministrinë e Shëndetësisë. IT ishte i pranishëm gjatë këtyre takimeve si këshilltar i BB. Gjatë njërit prej këtyre takimeve FC i ishte thënë se nuk çohen shokët në gjyq.⁷⁰

Më 30 Dhjetor 2011 u mbajt një takim në zyrën e IT në lidhje me incidentin që ndodhi në mes të BM dhe BF.⁷¹

Konstatimet

Sipas FC, ai nuk e di nëse atij i ishte drejtuar IT apo BB. Deklaratat e dhëna nga EM dhe HK mbështesin deklaratën e dhënë nga FC se kjo gjë ishte diskutuar. Këtyre dëshmitareve nuk u kujtohej se kush iu drejtua FC gjatë atij takimi. Si rezultat i kësaj nuk mund të vërtetohet se IT iu drejtua FC dhe prandaj ai duhet të lirohet nga akuzat në pikën 3 nën 1.

Gjatë intervistës së tij tek Prokurori më 5 Janar 2012, BM deklaroi disa here, pasi që ishte pyetur në mënyrë specifike nga Prokurorja se ai nuk ishte kërcënuar nga askush në Ministrinë e Shëndetësisë. Fjalët e përdorura nga BF dhe IT sipas pikës 3.2 të aktakuzës, nuk ishin konfirmuar nga BM gjatë dëshmisë së tij në Gjykatë. Kjo, duke marrë krahas me deklaratën e tij para prokurorit se ai nuk ishte kërcënuar na qon tek konkludimi se kërcënimet e bëra BM nuk mund të provohen.

Kështu që BF dhe IT janë liruar nga akuzat nën pikën 3 të aktakuzës.

Akuza 6

Prokuroja u tërhoq nga akuzat kundër IT për pikën 6, shpërdorim i detyrës zyrtare në bashkë kryerje me NS. Për këtë arsye akuza kundër të pandehurit refuzohet.

Akuza 8

Faktet e vërtetuara

Diku në ose rreth Nëntorit 2010 HF kishte një takim me FL në të cilin ai kërkoi 10% hise nëse ai donte që kontrata e tij të vazhdohej.⁷² Në fillim të vitit 2011 ai u takua me MA prej të cilit kërkoi 10% hise që të fitoj kontratë me Ministrinë e Shëndetësisë.⁷³

Më 2007 IH i tha FC se ai nuk duhet të diskutoj çështjet rreth parave me IT drejt për drejt, që nënkupton se do të ketë kërkesa për ryshfet.⁷⁴

Konstatimet

⁷⁰ ⁷⁰ Deklarata e FC, procesverbali i Shqyrtimit Kryesor më 14 Shkurt 2013, faqe 48

⁷¹ ⁷¹ Deklarata e BM, procesverbali i Shqyrtimit Kryesor më 21 Shkurt 2013, faqe 6

⁷² FL, procesverbal i Shqyrtimit Kryesor të 21 Shkurt, faqe 20; BEB, procesverbal i Shqyrtimit Kryesor të 7 Mars 2013, faqe 11; CG, procesverbal i Shqyrtimit Kryesor të 8 Mars 2013, faqe 4;

⁷³ Deklarata e MA, procesverbal i Shqyrtimit Kryesor të 1 Mars 2013, faqe 5;

⁷⁴ Deklarata e FC, procesverbal i Shqyrtimit Kryesor të 14 Shkurt 2013, faqe 42;

Nuk ka prova qe vërtetojnë se IT kishte kërkuar ryshfet personalisht. Po ashtu asnjë provë nuk u prezantua se IT përmes IH dhe/ose HF kishte kërkuar përqindje në shkëmbim të kontratave. Fakti se MA e kuptoi se me fjalën shëf ishte menduar IT, nuk e dëshmon se HF e kishte fjalën për IT kur ai e tha këtë. Edhe nëse ai e kishte bërë këtë kjo nuk dëshmon se IT në fakt kishte kërkuar nga HF të kërkoj ryshfet.

Biseda në mes të IH dhe FC ishte, duke u bazuar në letër, jo kërkesë për ryshfet por me tepër informative. Sikur se IH shpjegoi atij mënyrën se si duhet të ishin gjërat.

Provat kundër HF përbehen nga deklaratat e MA dhe FL. Edhe pse ata nuk i referohen të njëjtës ngjarje, Gjykata i konsideron ata të jenë vërtetuese.

Akuza 9

Ligji Fiskal

Gjatë periudhës qe mbulohet me aktakuze ligji i aplikueshëm ishte Rregullorja e UNMIK-ut 2004/52. Sipas nenit 26.1 të kësaj rregulloreje, të gjithë taksapaguesit janë të detyruar të përgatisin deklarinë vjetor fiskal më ose me herët se 1 Prilli i vitit në vijim të periudhës fiskale. Deklarimi duhet të përfshijë, përveç tjerave, të ardhurat e bruto nga të gjitha burimet, zbritjet e lejueshme, dhe të ardhurat qe i nënshtrohen taksave. Neni 3.1 i Rregullores thotë se objekt fiskal për një taksapagues rezident duhet të jenë të ardhurat fiskale prej burimeve të të ardhurave në Kosovë si dhe burim i të ardhurave nga jashtë shteti. Te ardhurat qe taksohen për periudhën fiskale, sipas nenit 4.1 nënkupton diferencën në mes të ardhurave bruto të pranuar apo të shtuara gjatë periudhës fiskale si dhe kontributeve të lejuara sipas Rregullores së tanishme kur behet fjale për të ardhura të tilla bruto.

Faktet e vërtetuara

Gjate viteve 2006, 2007 dhe 2008 IT pranoi pagesa nga Zvicra në llogarinë bankare të tij qe përfundon me 126.⁷⁵ Ai asnjëherë nuk i kishte deklaruar këto të ardhura tek autoritetet tatimore, deri në momentin kur ai u ndoq për evazion fiskal. Me 24 gusht 2010 IT i informoi zyrtarët tatimore për këto të ardhura nga jashtë shteti. Duke u bazuar në raportin financiar të datës 12 gusht 2011 Administrata Tatimore e Kosovës a ngarkoi IT me vlerën themelore tatimore prej € 20,245.90 për vitet 2005-2009.⁷⁶ Nga Letrat Përkujtuese për Pagesat për vitet 2006⁷⁷ nën artikullin 40 është e qartë se tatimi i papaguar për këto vite ishte respektivisht €5835,80, €5869,06 dhe €1984,99. Shuma totale e tatimit të papaguar është € 13,689.85. Pasi qe kjo është me pak se €15000, neni 249, paragrafi 2 i KPK-së nuk zbatohet. Shuma e cila përmendet në Raportin Financiar është detyrimi total duke përfshirë kamatën dhe penaltinë.

Konstatimet

⁷⁵ Dosja 23 me pasqyrë të llogarive bankare, faqe 174-226;

⁷⁶ Raporti i Policisë OCIU/12/201110812/2471, Dosja 61, faqe 27

⁷⁷ Dosja 46, faqe 241

IT , duke mos deklaruar të ardhurat e marra nga Zvicra, para ose më 1 Prill të vitit që pason vitin për të cilin të ardhurat ishin fituar shkeli nenin 26.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2004/52. Me këtë ai iu shmang tatimit që ai ishte dashur të paguaj për të ardhurat e tij. Shpjegimi i tij se ai nuk e kishte ditur faktin se duhej të paguaj tatim, sepse ai mendonte se taksat ishin paguar nga Fondi Pensional Zviceran nuk pranohet nga Gjykata, sepse ky pohim është në kundërshtim me sfondin edukativ të IT. Gjykata konsideron se IT si person me edukim të lartë dhe përvojë në menaxhment të Ministrisë ka qenë shume mirë në dijeni me faktin se secila e ardhur është nën tatim si dhe ka qenë mjaft i informuar me karakterin e të ardhurave nga Zvicra. I pandehuri është dashur të siguroj vetveten që tatimi të hiqet nga pagesat. Duke mos e bërë këtë ai qëllimisht e pranoi ndryshimin që ai mori si pagese bruto dhe veproi me tentative eventuale.

Gjykata, mosdeklarimin e të ardhurave e konsideron të jetë një vepër penale në vazhdimësi që ishte përmbushur në momentin kur të ardhurat ishin deklaruar më 24 Gusht 2010. Kalkulimi i periudhës së parashkrimit fillon nga kjo datë. Për veprat penale të dënueshme pasi që aktakuza ishte ngritur me 7 korrik 2012, periudha e parashkrimit është ndërprerë.

Akuza 10

Faktet e vërtetuara

IT në muajt Maj dhe Qershor 2012 kishte diskutuar mënyrat se si të tërhiqen akuzat kundër tij, duke kontaktuar zyrtarë në qeverinë e Kosovës dhe përbrenda EULEX.⁷⁸ Në emër të tij ishin dërguar letra tek këto institucione. Ai po ashtu ishte në kontakt me një zyrtar të Ministrinë e Shëndetësisë i cili e informonte atë në lidhje me kërkesat që ishin bërë për dokumente. Për me tepër ai përmendi emrat e palëve që ishin të kyçura në çështje dhe foli për neutralizimin e dëshmitareve.

Konstatimet

Pengimi i të provuarit siç parashihet me nenin 309 paragrafi 1 dhe 2 të KPK-së përbehet nga detyrimi i dëshmitarit ose ekspertit me përdorim force, kërcenim të përdoret forca ose me mënyra tjera të shtrëngimit ose me premtim apo dhuratë apo çfarë do forme tjetër të përfitimit të japë deklaratë të rrejshme në Gjykatë apo, fshehjen, shkatërrimin, dëmtimin ose nxjerrjen e një dokumenti të pa shërbyeshëm, i cili do të mund të përdorej si provë me qëllim të parandalimit apo vështirësimit të mbledhjes së provave në procedure Gjyqësore.

Veprimet e përshkruara në aktakuzë dhe të konsideruara të vërtetuara nga provat e prezantuara nuk janë vepra që mund të kategorizohen nën veprimet e përshkruara të nenit 309 paragrafi 1 dhe 2 i KPK-së. Pasi që nuk ka prova se ekspertet ose dëshmitaret se në fakt ishin kontaktuar nga i pandehuri ose në emër të tij, Gjykata vjen në konkludim që nuk ka pas ndonjë përpjekje të bërë për të penguar provat. Gjykata vëren se mënyra se si i pandehuri

⁷⁸ Dosja e përgjimeve Maj-Qershor

ishite përpjekur të pengoj procedurat nuk është e pranueshme por as nuk përben veprë penale të pengimit të provave.

Përgatitja e veprës penale nuk e dënueshme nën KPK-ne të zbatueshëm. Edhe nëse veprimet e ndërmarra nga i pandehuri IT do të përmbushnin kriterin për këtë formë të përgjegjësisë penale, të cilat nuk i përmbushin, nuk do të kishte baza për një dënim.

Kështu që i pandehuri IT duhet të lirohet meqenëse veprimet e vërtetuara nuk përbejnë veprë penale.

Akuza 11

Faktet e vërtetuara

Me 13 korrik 2010 IT u arrestua për shmangie nga tatimi. Ai u lirua me kusht me 11 Korrik 2010. Me 8 shtator 2010 Gjykata Supreme e Kosovës e aprovoi ankesën e parashtruar nga IT kundër vendimit të Komisionit për Emërime të Larta Publike për heqjen e tij nga pozita e Sekretarit të Përhershëm në Ministrinë e Shëndetësisë.⁷⁹ Më 24 shtator 2010 BB kërkoi një mendim ligjor nga departamenti ligjor brenda Ministrisë së Shëndetësisë në lidhje me këtë çështje.⁸⁰ Në përgjigjen e tyre departamenti ligjor e informoi BB që vendimi nga GJS ishte ekzekutuar, porse komisioni për emërimin e zyrtareve të larte nuk ekzistonte më.

Më 28 shtator 2010 BB e ktheu në detyrë IT si Sekretar i Përhershëm në Ministrinë e Shëndetësisë.

Konstatimet

Neni 69 i Ligjit mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës thotë se Shërbyesit Civil duhet që menjëherë të suspendohen nga të gjitha detyrat kur procedura penale iniciohet kundër Shërbyesit Civil në lidhje me veprë të pretenduar penale e kryer dhe që ka të bëjë me ushtrimin e funksioneve të tij/saj. Sipas Prokurorisë BB qëllimisht nuk e ka zbatuar këtë nen kur ai e kishte kthyer IT në detyrën e tij. I pandehuri BB thotë se ai nuk e ka ditur se IT ishte nën hetime për vepra të tjera përveç veprës së shmangies nga tatimi. Edhe pse Prokurorja thotë se ai do të duhej ta dinte këtë për shkak se “kjo ishte publikuar gjerësisht” ajo nuk prezantoi prova që ta vërtetoj këtë.

Pasi që shmangia nga tatimi nuk ishte i lidhur me ushtrimin e detyrave të tij, nuk kishte bazë që IT të suspendohej nga shërbimi civil në bazë të nenit 69 të Ligjit mbi Shërbimin Civil.

Kthimi i IT në detyrë nuk përben veprë penale dhe për këtë arsye i pandehuri BB u deshtë të lirohet nga akuza nën pikën 11.

Akuza 12

Faktet e vërtetuara

⁷⁹ Dosja e Provave Shtesë 1, faqe 88-89

⁸⁰ Dosja e Provave Shtesë 1, faqe 96

Më 24 Dhjetor 2010 një takim u mbajt në zyrën e IT, ku të pranishëm ishin EM, IT, HF, dhe BF.⁸¹ Gjatë këtij takimi ishte diskutuar vlerësimi i shortit të Imatinib-it për tenderin 71300 10 647 111. Më 28 Dhjetor 2010 EM ishte larguar nga posti i tij.

Konstatimet

EM deklaroi se ishte nën presion nga IT dhe HF që të nënshkruaj formën e vlerësimit për shortin e Imatinib-it në tenderin 71300 10 647 111 dhe te ju jep tenderët ofertuesve edhe pse nuk kishte mjaft ofertues të përgjegjshëm.⁸²

IT konfirmoi se takimi ishte mbajtur në zyrën e tij më 24 Dhjetor 2010 për shortin e Imatinib-it në tenderin 71300 10 647 111. Ai mohoi të ketë vënë presion ndaj EM që të nënshkruaj vlerësimin për këtë short, duke i dhënë FXit kontratën për këtë tender. EM donte që ta nënshkruante formën e vlerësimit vetëm nëse ishte e bashkë-nënshkruar nga IT gjithashtu.⁸³

HF dhe BF deklaruan në pajtim me deklaratën IT.⁸⁴

Dëshmia e dhënë nga EM nuk mbështetet nga prova të tjera. Ankesa e tij tek OSHP nuk mund të konsiderohet si e tillë, për shkak se burimi i kësaj prove është i njëjte: EM. Format e vlerësimit të dhënies se kontratave ofertuesve më të lirë për shortet ku kishte më pak se tre ofertues të përgjegjshëm nuk ishin prezantuar si prova. Gjithashtu kontratat e nënshkruara për këto shorte nuk janë prezantuar si prova.

Gjykata konstaton se nuk mund të provohet se IT dhe HF i bënë presion EM të nënshkruaj format e vlerësimit për shortet edhe pse kjo ishte në kundërshtim me Ligjin mbi Prokurimin Publik dhe rregullat e patentave ndërkombëtare.

Dënimet

Për sa i përket dënimeve, Gjykata ka marrë parasysh si në vijim: veprat e kryera si dhe veprat për të cilat të pandehurit janë shpallur fajtor, ishin kryer në pozitë zyrtare, përveç shmangies nga tatimi. Njerëzit duhet t'i besojnë qeverisë së tyre dhe qeveria duhet ta fitoj këtë besim. Duke kryer këto vepra në detyrë zyrtare, popullata humb besimin në qeveri.

Gjykata vërejti gjatë gjykimit se kishte një mungesë të përgjithshme të marrjes së përgjegjësisë për veprimet e dikujt. Dëshmitaret dhe të pandehurit dëshmuan se ata nuk ishin përgjegjës edhe pse ishin të përfshirë në disa aktivitete. Një shoqëri mund të funksionoj vetëm nëse zyrtarët marrin përgjegjësi dhe qytetarët kërkojnë nga ata që të marrin këtë

⁸¹ Deklarata e EM, procesverbali i Shqyrtimit Kryesor më 13 Mars 2013, faqe 18, Deklarata e HF, procesverbali i Shqyrtimit Kryesor më 22 Maj 2013, faqe 36, Deklarata e IT, procesverbali i Shqyrtimit Kryesor më 29 Maj 2013, faqe 16,

⁸² Deklarata e EM, procesverbali i Shqyrtimit Kryesor më 13 Mars 2013, faqe 18,

⁸³ Deklarata e IT, procesverbali i Shqyrtimit Kryesor më 29 Maj 2013, faqe 16

⁸⁴ Deklarata e HF, procesverbali i Shqyrtimit Kryesor më 22 Maj 2013, faqe 36, , Deklarata e BF procesverbali i Shqyrtimit Kryesor më 23 Maj 2013, faqe 33

përgjegjësi. Veprat e kryera janë vepra të rënda që minojnë kredibilitetin dhe qëndrueshmërinë e qeverisë.

Për këtë arsye Gjykata konstaton se duhet të ipen dënime të rënda. Në anën tjetër Gjykata ka marrë parasysh se hetimet e bëra nga Prokuroria ishin qartë për të hetuar këta të pandehur dhe asgjë tjetër. Nga deklaratat e njërit të pandehur mund të shihet se kur ai donte të fliste për gjerat që i kanë ndodhur atij në Ministrinë e Shëndetësisë gjate viteve 2008 dhe 2009, Prokurorja e Shtetit e kishte pyetur nëse kjo ishte gjatë kohës kur IT ishte në detyrë apo jo, e nëse jo ajo nuk ishte e interesuar të dëgjonte. Nuk ka pasur një hetim të hapur që të zbulohet se çfarë kishte ndodhur në Ministrinë e Shëndetësisë por një kërkim për prova në mënyre që të dënohen disa të pandehur të caktuar. Për sa i përket veprave të kryera në vitin 2007, Gjykata vëren se këto vepra janë hetuar qysh nga 2008 –ta, dhe pasi që tani jemi në vitin 2013 kjo çështje nuk është gjykuar pa ndonjë vonesë të panevojshme. Për shkak të kësaj vonese Gjykata i ka zbutur këto vepra.

Gjithashtu fakti se të pandehurit nuk janë dënuar me parë është marrë parasysh.

Dënimet plotësuese mbi ndalimin e ushtrimit të funksioneve në shërbime publike justifikohet nga fakti se veprat janë kryer gjate ushtrimit të pozitave zyrtare.

Cornelie Peeck

Joseph Hollerhead

Mjeti ligjor:

Personat e autorizuar mund të parashtrojnë ankesë në formë të shkruar kundër këtij aktgjykimi përmes Gjykatës Themelore të Prishtinës tek Gjykata e Apelit brenda pesëmbëdhjete ditësh nga dita kur një kopje e aktgjykimit u dorëzohet palëve, sipas Nenit 380 paragrafi 1 i KPP-së.

Përkthimi i Aktgjykimit prej Gjuhës angleze në Gjuhën shqipe:

A.P.

A.Sh.

N.Sh.

Shtojca B

Dëshmitarët

AB më 8 mars 2013

ALL me 21 mars Mars 2013

APO me 14 mars 2013

AT me 28 mars 2013

AG me 15 shkurt 2013
AL me 28 mars 2013
BG me 21 mars 2013
BD me 13 dhe 14 shkurt 2013
BM me 21 shkurt 2013
BEB me 7 mars 2013
BMU me 7 mars 2013
BS me 27 mars 2013
CG me 8 mars 2013
DK me 22 mars 2013
EM me 13 dhe 14 mars dhe 31 maj 2013
FL me 21 dhe 22 shkurt 2013
FA me 22 Mars 2013
FC me 14 dhe 15 shkurt 2013
HM me 15 mars 2013
HE me 15 mars 2013
HZ me 22 Mars 2013
HK me 8 mars 2013
IHA me 21 mars 2013
JS me 27 mars 2013
LMU me 22 mars 2013
LM me 22 dhe 28 Shkurt 2013
MM me 27 mars 2013
MK me 28 shkurt 2013
MA me 28 shkurt dhe me 1 mars 2013
MR me 28 mars 2013
PB me 29 mars 2013
RH me 21 mars 2013
XM me 28 mars 2013
Dëshmitaret Ekspertë
AS me 11 prill 2013
Komisioni i ekspertëve të penjve me 17 maj 2013

Të pandehurit

IH me 16 maj 2013
AP me 16 maj 2013
BB me 7 dhe 22 maj 2013
HF me 22 maj 2013
BF me 23 maj 2013
ZK me 24 maj 2013
IT me 24, 29 dhe 30 maj 2013